

FATMIRA MUSAJ

MARRËDHËNIET SHQIPTARO-GREKE (1925-1928)

Zhvillimi i marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë me Greqinë, në vitet 1925-1928, përbënte një aspekt të rëndësishëm të politikës së jashtme të shtetit shqiptar. Në kuadër të këtyre marrëdhënieve, qeveria shqiptare u përqendrua në dy drejtime të rëndësishme.

Së pari, të vazhdonte mbrojtjen e interesave të shqiptarëve në Greqi. Në këtë drejtim ajo do të duhej të vijonte të ushtronte presion pranë qeverisë greke dhe në Lidhjen e Kombeve (LK), për të ndaluar shkëmbimin e mëtejshëm të popullsisë shqiptare, spastrimin etnik të Çamërisë dhe të fshatrave me popullsi shqiptare në prefekturën e Janinës,¹ pa lënë mënjanë edhe zgjidhjen e çështjes së pasurive të kësaj popullsie.

Së dyti, të përballonte përpjekjet e shtetit grek për të ndërhyrë në punët e brendshme të Shqipërisë, në interes të synimeve të tij politike, ekonomike, kulturore e territoriale.

Problemet e pazgjidhura midis dy shteteve ishin rezultat i politikës që ndoqi Greqia ndaj popullsisë shqiptare pas aneksimit në korrik 1913, e cila iu nënshtrua politikës helenizuese që synonte tjetërsimin e rrënjëve të identitetit shqiptar.² Në interes të kësaj politike, Athina shfrytëzoi edhe Traktatin e Lozanës (Janar 1923), për të larguar shqiptarët myslimanë nga vendi i tyre me anë të shkëmbimit të popullsisë midis Greqisë e Turqisë. Komisioni grek për ekzekutimin e traktatit u mbështet mbi parimin e fesë e jo të gjuhës e të “ndërgjegjes kombëtare”.³ Kjo pati pasoja të jashtëzakonshme për popullsinë shqiptare myslimane, në mënyrë të veçantë për minoritetin çam. Komisioni grek për ekzekutimin e traktatit shkeli vendimin e Konferencës së Lozanës dhe padrejtësisht e zëvendësoi

¹ Beqir Meta, *Tragjedia çame*, Tiranë: Klean, 2010, f. 34; Dhimitër Berati, *Shënime historike. Mbi marrëdhëniet e Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve*, Tiranë: Husi Borshi, 2007, f. 43. Sipas Dh. Beratit numri i përgjithshëm i shqiptarëve në Greqi ishte 90 mijë, prej të cilëve 50 mijë jetonin në Çamëri.

² Anastasia N. Karakarsidi, *Fusha e grurit, Kodra të gjakut*, Tiranë: Plejad, 2006, f. 10.

³ Richard Clogg, *Histori e përmbledhur e Greqisë*, Tiranë: Toena, 2004, f. 101.

atë me interpretimin, sipas të cilit përjashtoheshin nga shkëmbimi ata shqiptarë që vetë ose prindërit e tyre kishin lindur në territore që i takonin shtetit shqiptar.⁴ Në arsyetimin e Mit'hat Frashërit, ministër fuqiptotë i Shqipërisë në Greqi (1923-1926), kjo do të thoshte që “shumica e shqiptarëve me origjinë nga territoret autoktone të Epirit, Pindit e Maqedonisë Juglindore që kishin lindur në shtetin grek, konsideroheshin thjesht myslimanë dhe si të tillë përfshiheshin në shkëmbim me një kombësi si ajo e Turqisë”.⁵ Po sipas tij, prej vitit 1923 deri në fillim të vitit 1925, u arrit të shpërnguleheshin nga vatrën e tyre afro 35 mijë shqiptarë myslimanë në 38 fshatrat të Follorinës e Kosturit si dhe largimi i mijëra banorëve të Çamërisë, të cilët u konsideruan si turq ose grekë të islamizuar.⁶

Qarqet e Athinës e konsideruan këtë politikë si çështje të brendshme dhe vazhduan përpjekjen për realizimin e saj. Pas Luftës së Parë Botërore, Greqisë iu hoq mundësia për të ndërhyrë ushtarakisht në “trevat e paçliruara të Vorio Epirit” për shkak të tkurrjes së “Idesë së Madhe” greke me Traktatin e Lozanës, ndryshimeve politike në Shqipëri në fillim të viteve '20 dhe përcaktimit në Protokollin e Firences, të korrikut të 1926-ës, të kufirit shtetëror të Shqipërisë me Greqinë dhe Jugosllavinë.⁷ Megjithatë, çështja e “Vorio Epirit” mbeti një nga pikat më të qëndrueshme të politikës së jashtme greke.⁸ Athina vazhdoi përpjekjet për influencë politike, arsimore, kulturore e fetare në Shqipërinë e Jugut. Në interes të kësaj politike ajo, përkrahu edhe Ahmet Zogun për rrëzimin e qeverisë së Fan Stilian Nolit. Në këmbim të ndihmës, në gusht 1924 ajo i paraqiti disa kërkesa në Beograd dhe mori premtimin prej tij, për mosndërhyrje të shtetit shqiptar në autoqefalinë e Kishës Ortodokse Shqiptare (KOSH), për hapjen e shkollave greke në trevat e Shqipërisë së

⁴ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V) 1924, Dosja (më tej: D.) 79, fl. 42-45, Letër e komisionit të ngritur në emër të çamëve, drejtuar Eleftheros Venizellos, Athinë, 11 janar 1924.*

⁵ *Po aty*, fl. 59-63. Sqarim i Mit'hat Frashërit për kryetarin e Komisionit Mikst, rreth termit të origjinës shqiptare.

⁶ *AMPJ, V. 1925, D. 131, fl. 23-28, Telegram i M. Frashërit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Athinë, 29 janar 1925; Hajredin Isufi, Çamëria, studime historike-sociologjike (shek. XIII-XX), Tiranë: Pegi, 2006, f. 118.*

⁷ R. Clogg, *Histori e përmbledhur...*, f. 101.

⁸ Pëllumb Xhufi, “Megali-Idea” në marrëdhëniet shqiptaro greke” në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2006, f. 20.

Jugut, për tjetërsim të pronës shtetërore në Sarandë në dobi të nënshtetasve grekë, etj.⁹

Pas kthimit të A. Zogut në pushtet në dhjetor 1924, Athina zyrtare pati një farë interesimi për marrëdhënie të fqinjësisë së mirë me Shqipërinë, për shkak edhe të zhvillimeve të brendshme politike në Greqi dhe përpjekjeve për të zënë vend në realpolitikën ballkanike. Kjo përkoi me ardhjen në pushtet në qershor të vitit 1925 të arvanitasit Theodoros Pangallos-it, në postin e kryeministrit, ndërkohë që postin e presidentit e mbante një tjetër arvanitas, Pavlos Kunduriotis. Deklaratat e tyre për zhvillimin e marrëdhënieve pozitive greko-shqiptare sollën një frymë të re në politikën me Shqipërinë si në qëndrimin e shqiptarëve me banim në Greqi dhe në rishikimin e pikëpamjeve në çështje të “Vorio Epirit.”¹⁰ Edhe A. Zogu për arsye të vështirësive politike e ekonomike të vendit, ishte i prirur për zhvillimin pozitiv të këtyre marrëdhënieve por, pa lejuar ndërhyrjen e Greqisë në punët e brendshme të shtetit shqiptar.¹¹

Pavarësisht deklaratave të autoriteteve të larta të Athinës, për Mit’hat Frashërin, institucionet shtetërore vazhdonin të njëjtën politikë, për të detyruar shqiptarët çamë të linin vendin e tyre.¹² Në këtë drejtim ndihmoi edhe zvarritja e raportit të anëtarëve të Komisionit Mikst dhe të nënkomisioneve të Epirit e Maqedonisë, për çështjen e origjinës e të pasurive të shqiptarëve në Greqi, të cilët sipas Dh. Beratit ishin në shërbim të Greqisë e Turqisë.¹³

Qeveria greke, në vazhden e masave për dëbimin e shqiptarëve në mars 1925, botoi një komunikatë zyrtare ku, mbështetur në artikullin 3 të Traktatit të Sevres (1920), u kërkonte shqiptarëve në territoret veriore të shtetit grek të paraqiteshin në zyrat e pushtetit lokal deri më 6 gusht 1925 dhe të deklaronin nënshtetësinë greke ose shqiptare. Vendosja e shqiptarëve para kësaj alternative, i detyronte ata që pas një viti të deklarimit të nënshtetësisë, të largoheshin nga Greqia e të mos ktheheshin

⁹ *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και Ελληνοαλβανικές Σχέσεις*, επιμέλεια: Βασίλειος Κόντης, Έγγραφα από το Ιστορικό Αρχείο του Υπουργείου Εξωτερικών, Τόμος III (1922-1929), Αθήνα: Εστιασ, 2004, dok. nr. 47, Telegram i ambasadorit grek në Beograd, Camadhos për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Beograd, 3 shtator 1924.

¹⁰ *AMPJ*, V. 1924, D. 225, fl. 401, Gazeta “Eleftheron Vima”, shkurt 1925.

¹¹ *Po aty*, V. 1925, D. 32, fl. 250, Gazeta “Politia”, 8 shtator 1925.

¹² *Po aty*, V. 1925, D. 131, fl. 47, Telegram i M. Frashërit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Athinë 29 janar 1925.

¹³ Dh. Berati, *Shënime historike...*, f. 50.

më aty.¹⁴ Ky akt rrezikonte përpjekjet e tyre për të fituar të drejtat e shkelura nga ligjet greke mbi pasurinë dhe në të njëjtën kohë të humbisnin edhe atë pak pasuri, të cilën me ligj e kishin të ndaluar ta shisnin.

Në fakt, vetë komunikata ishte në shkelje të artikullit 3 të Traktatit të Sevres, i cili theksonte se, Greqia pranonte nënshtetësinë greke de fakto dhe pa kërkuar asnjë formalitet, për shtetasit bullgarë, turq ose shqiptarë me banim në territorin e aneksuar prej saj. Ai u njihte të drejtën e optimit vetëm atyre që kërkonin vullnetarisht të deklaronin dhe u siguronte të drejtën për të mbajtur pasuritë e tyre të paluajtshme në territorin grek dhe të merrnin pasuritë e tyre të luajtshme të çdo lloji.¹⁵ Në shkelje të këtij artikulli, autoritetet greke u kërkonin shqiptarëve deklarimin e nënshtetësisë, vendin ku do të udhëtonin, ndërsa vizën në pasaportë e shoqëronin me shënimin “sans retour” (pa kthim). “Këto ngatërresa- theksonte Abdul Sula, në atë kohë konsulli shqiptar në Selanik- i bëjnë duke shpjegue sipas qejfit të tyre, artik. 3 të Sevres dhe duke e shkelur atë”.¹⁶

Frenimin e kësaj politike, përfaqësuesi i Shqipërisë në Athinë, Mit’hat Frashëri e shihte në arritjen e nënshkrimit të marrëveshjes së nënshtetësisë dhe i kërkoi qeverisë së tij, të hynte në bisedime me qeverinë greke për këtë çështje, ashtu siç po vepronin për bashkë-kombësit e tyre në Greqi, Itali, Serbi, Angli, etj.¹⁷

Qeveria shqiptare për të mbrojtur të drejtat e qytetarëve të saj në Greqi si dhe të atyre në Turqi e Egjipt, kërkoi të hynte në bisedime për nënshkrimin e marrëveshjeve, në mënyrë të veçantë atë të nënshtetësisë, konsullore dhe vendbanimit. Me anën e tyre, palët nënshkruese viheshin përpara detyrimeve për respektimin e të drejtave të nënshtetasve të kombësive respektive, në mbrojtje të jetës, banesës e pasurisë së tyre, për

¹⁴ AMPJ, V. 1925, D. 131, fl. 301-303, Telegram i M. Frashërit, drejtuar MPJ, Athinë, 25 maj 1925.

¹⁵ B. Meta, *Tragjedia çame...*, f. 32.

¹⁶ AMPJ, V. 1925, D. 38, fl. 126, Telegram i konsullit shqiptar në Selanik, drejtuar legatës shqiptare në Athinë, Selanik, 20 qershor 1925.

¹⁷ *Po aty*, V. 1925, D. 212, fl. 49, Telegram i M. Frashërit drejtuar MPJ në Tiranë, Athinë, 23 shkurt 1925.

të përcaktuar e pranuar kriteret e të drejtës së optimimit për shqiptarët në shtetet përkatëse.¹⁸

Ministria e Jashtme greke dhe legata shqiptare në Athinë, më 11 gusht 1925 ranë dakord për fillimin e bisedimeve dhe se, deri në arritjen e një marrëveshjeje mbi kombësinë e nënshtetësinë, qeveria greke do të lejonte lëvizjen pa kushte të nënshtetasve grekë me origjinë shqiptare dhe të atyre të deklaruar nënshtetas shqiptarë sipas urdhrit të komunikatës. Gjithashtu u kërkua që edhe qeveria shqiptare të vepronte në të njëjtën mënyrë me nënshtetasit shqiptarë me kombësi greke në Shqipëri.¹⁹

Në fund të gushtit 1925, qeveria shqiptare ngriti komisionin përkatës me anëtarë: Koço Kotën ministër i Punëve Botore, Terenc Toçin kryetar i Gjykatës së Diktimit, Faro Gjata drejtor i drejtorisë politike në Ministrinë e Punëve të Jashtme (MPJ) dhe Teki Selenicën, kryetar i seksionit të dytë në Ministrinë e Punëve të Brendshme (MPB). Komisioni do të përgatiste raportin për gjendjen e minoritetit dhe të nënshtetësisë për shqiptarët në Greqi dhe të propozonte masat që duheshin marrë.²⁰ Në raportin e paraqitur në MPJ analizohej gjendja e shqiptarëve në Greqi dhe veçanërisht e minoritetit çam, mohimi i të drejtave të tyre të siguruara nga konventa e LK për minoritetet. Komisioni i propozoi qeverisë të fillonte bisedimet me qeverinë greke për marrëveshjen e nënshtetësisë e

¹⁸ Arben Puto, *E drejta ndërkombëtare publike*, vëll. 2, Tiranë: Albin, 2000, f. 9. Sipas prof. Putos, mundësia e përfitimit të nënshtetësisë mund të krijohet edhe kur bëhen ndryshime territoriale (si në rastin e Shqipërisë, e cila u copëtua nga vendimet e Konferencës së Ambasadorëve në Londër – F.M.). Kur një pjesë e territorit të një shteti i kalon shtetit tjetër, atëherë shtrohet çështja e shtetësisë së banorëve të kësaj pjese të territorit. Në të tilla raste çështja e shtetësisë mund të zgjidhet në dy mënyra: a) me anë të *transfertit*, që do të thotë, ndryshimi automatik i shtetësisë dhe fitimi i shtetësisë së shtetit të cilit i shkonte territori; dhe b) me anë të *optimimit*, që do të thoshte, që popullsisë së territorit i jepej mundësia të zgjidhte midis dy shtetësive. Ndryshe nga disa marrëveshje ndërkombëtare të shek. XVIII, të cilat parashikonin që ata që ruanin shtetësinë e vjetër, të hiqnin dorë nga çdo pasuri që mund të kishin në territorin e aneksuar, në kuptimin e sotëm optimi është e drejtë që u njihet banorëve të një territorit, që kalon nga duart e një shteti në duart e një shteti tjetër, për të zgjedhur shtetësinë që duan me anë të deklaratave individuale. Banorët që vendosin të ruajnë shtetësinë e vjetër zakonisht largohen nga territori në fjalë për t'u vendosur në shtetin e tyre, por ata nuk i humbasin të drejtat pasurore që mund të lënë pas.

¹⁹ *AMPJ*, V. 1925, D. 38, fl. 131, Telegram i M. Frashërit drejtuar MPJ në Tiranë, Athinë, 1 gusht 1925.

²⁰ *Arkivi Qendror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), F. 149, V. 1925, D. I-758. fl. 158, Vendim i Këshillit të Ministrave, Tiranë, 30 gusht 1925.

konventave të tjera, të cilat duhej të ishin të pavarura nga Traktati i Sevres.²¹

Qeveria shqiptare, deri në fund të 1925-ës, i dërgoi 3 nota Athinës, ku shprehte gatishmërinë për fillimin e bisedimeve, por nuk mori përgjigje, përveç vendimit të Ministrisë së Jashtme greke, për zgjatjen e afatit të marrëveshjes provizore për deklarimin.²²

Tërheqja e qeverisë greke, duket se kishte të bënte me bisedimet greko-turke për marrëveshjen e shkëmbimit të 5 mijë banorëve të Çamërisë me 5 mijë të krishterë shqiptarë nga Turqia, e cila u bë e njohur më 17 nëntor 1925.²³ Por, mundet të ishte edhe si reagim i Athinës për kundërshtimin e prerë të presidentit A. Zogu ndaj kërkesave të saj për zbatimin e premtiveve.²⁴

Marrëveshja me Turqinë shqetësoi qeverinë shqiptare, e cila i kërkoi përfaqësuesit të saj në LK, që ta shtronte çështjen në seksionin për minoritetet dhe ta fuste në rendin e ditës në mbledhjen e dhjetorit të 1925-ës. Ndërkohë, LK i tërhoqi vëmendjen qeverisë greke dhe e njoftoi për trajtimin e çështjes në mbledhjen e dhjetorit.²⁵

Më 10 dhjetor, Mehdi Frashëri informoi Këshillin e LK për gjendjen e rëndë të shqiptarëve në Çamëri, denoncoi marrëveshjen greko-turke për përfshirjen e shqiptarëve në shkëmbim, si dhe futjen në këtë proces të 800 banorëve të fshatrave Dragumi e Gardhiq. Njëkohësisht ai propozoi që t'i jepej fund shkëmbimit në Çamëri, të ngrihej një komision shqiptaro-grek nën kryesinë e një të huaji për të vlerësuar pasuritë e konfiskuara të shqiptarëve të larguar nga Greqia, i cili duhej të këshillonte qeverinë greke që ta pranonte atë vlerë.²⁶ Në të njëjtën kohë,

²¹ *Po aty*, fl. 144, Procesverbal nga diskutimi i raportit të komisionit për gjendjen e minoriteteve shqiptare në Greqi dhe çështjen e nënshtetësisë. Raporti kaloi në Këshillin e Ministrave me vendim nr. 481, Tiranë, 18.09.1925

²² *AMPJ*, V. 1926, D. 57, fl. 101, Telegram i M. Frashërit, drejtuar MPJ, Athinë, 14 janar 1926.

²³ *AQSH*, F. 152, V. 1925, D. 820, fl. 4, Telegram i ministrit të Punëve të Brendshme drejtuar Këshillit të Ministrave, Tiranë, 17 nëntor 1925; "Protestimi i qeverisë shqiptare" në *Gazeta e Korçës*, nr. 237, 21 nëntor 1925, f.1.

²⁴ *Ελληνισμός της Βορείου Ηπείρου και Ελληνοαλβανικές ...*, dok nr. 79, Telegram i legatës greke për Ministrinë e Punëve të Jashtme në Athinë, Durrës, 5 shtator 1925.

²⁵ *AMPJ*, V. 1925, D. 131/2, fl. 240, Telegram i Eric Drymond drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme në Tiranë, Gjenevë, 17 nëntor 1925; *AQSH*, F. 152, V. 1925, D. 820, fl. 6. Telegram i MPJ drejtuar MPB, 17 dhjetor 1925.

²⁶ *AMPJ*, V. 1926, D. 119, fl. 616. Raport i depozituar pranë Këshillit të Lidhjes së Kombeve; *Journal Officiel de la S.D.N.*, prill 1926, f. 511.

përfaqësuesi i Shqipërisë në Paris, Malik Libohova, ngriti çështjen pranë Konferencës së Ambasadorëve²⁷ dhe kërkoi ndihmë për zgjidhjen e saj. Por autoritetet drejtuese të saj, nuk e morën në konsideratë kërkesën e qeverisë shqiptare, me justifikimin se ajo ishte një çështje jashtë kompetencave të saj.²⁸

Qeveria shqiptare në pamundësi për të siguruar mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare për zgjidhjen e çështjeve me Greqinë, vijoi përpjekjet për të hyrë në bisedime me Athinën. Për këtë, A. Zogu në fund të dhjetorit 1925, dërgoi deputetin minoritar Vasil Bamiha, i cili për afro një muaj zhvilloi bisedime me zyrtarë të lartë të shtetit grek, edhe për çështjen e traktateve, të minoriteteve dhe të Kishës Ortodokse Shqiptare.²⁹ Në përfundim të bisedimeve qeveria greke vendosi në parim për arritjen e një marrëveshjeje miqësore me Shqipërinë. Në fund të janarit 1926, M. Frashëri në takim me ministrin e Jashtëm grek Rufos, i kërkoi shtyrjen e afatit të deklarimit të shqiptarëve, fillimin e bisedimeve për një marrëveshje përfundimtare për nënshtetësinë dhe lirimin e 104 shqiptarëve të burgosur padrejtësisht.³⁰ Ministri e informoi për vendimet e fundit të qeverisë greke, e cila ishte rënë dakord në parim për çeljen e bisedimeve, për një marrëveshje miqësie midis dy vendeve, për stabilitetin e transportit detar, për mbylljen e klubeve epirote, se hiqte dorë nga kërkesa e paligjshme për KOSH të cilën e konsideronin çështje të brendshme të shtetit shqiptar dhe nuk do të përziheshin në punët e saj, madje pohoi se ishte hequr dorë edhe nga pretendimet territoriale. “Tani e kuptuam, theksoi ai, se fuqia e një shteti nuk është për të marrë disa pëllëmbë tokë më tepër por për të fituar dashurinë e miqësinë e një

²⁷ Konferenca e Ambasadorëve i zhvilloi punimet në Paris. Ajo kishte për detyrë t'i jepte zgjidhje përfundimtare çështjeve të lëna pezull nga Konferenca e Paqes. Në lidhje me Shqipërinë, një prej çështjeve të lëna pezull ishte edhe ajo e kufijve përfundimtarë të shtetit shqiptar. Për më shumë shih Paskal Milo, *Politika e jashtme e Shqipërisë*, vëll. I (1912-1939), Tiranë: Toena, 2013, f. 517-572.

²⁸ *AMPJ*, V. 1926, D. 119, fl. 14. Telegram i presidentit të Konferencës së Ambasadorëve, Jul Cambon, për Malik Libohovën, Paris, 7 janar 1926.

²⁹ Beqir Meta, “Përpjekjet për konsolidimin e Kishës Autoqefale Shqiptare sipas optikës së diplomatëve britanikë në vitet 1925-1926”, në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2013, f. 65; Fatmira Musaj, “Ballafaqimi shqiptaro-grek për Kishën Ortodokse Autoqefale (1925-1928)” në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2015, f. 145.

³⁰ *AMPJ*, V. 1926, D. 68, fl. 4, Telegram i M. Frashërit drejtuar MPJ, Athinë, 30 janar 1926.

fqinji.”³¹ Dëshirën për të qenë në miqësi me Shqipërinë, Rufos e lidhi dhe me bisedimet për Paktin Ballkanik që po përparonin dhe, me rritjen e përpjekjeve serbe për hegjemoni në Ballkan të cilat rrezikonin jo vetëm Greqinë por edhe Shqipërinë e Bullgarinë.³² “Duke mbrojtur idenë e një Shqipërie të fortë, theksonte gazeta “Dielli”, Greqia mbron vehten e saj”.³³

Befasues dhe me interes për marrëdhëniet midis dy vendeve ishte pohimi i Pangallosit në lidhje me KOSH dhe ortodoksët shqiptarë, që shprehte një reflektim për politikën e ndjekur ndaj Shqipërisë. “Kemi bërë faje deri më sot dhe kemi gabuar, theksoi ai, duke pandehur se kombësia e bën kishën. Ortodoksët tuaj janë shqiptarë dhe jo grekë. Kishën duhet ta keni autoqefale.”³⁴

Bisedimet e Bamihës me Athinën tërhoqën vëmendjen e Italisë. Ajo ashtu si Jugosllavinë, donte ta mbante Greqinë larg synimeve të saj politike në Shqipëri. Për këtë Facendi, këshilltar i legatës italiane në Athinë, e paralajmëroi kryeministrin Pangallos, se Italia nuk do të lejonte ndërhyrje të politikës greke në Shqipëri dhe nëse do të cenohej independenca politike e saj, asnjëra palë nuk do të përfitonte.³⁵ Ndërsa shtypi në Beograd theksoi me ironi se “Shqipëria nuk përbën faktor për t’u llogaritur në politikën ballkanike në përgjithësi, sa që marrëveshja me të, të justifikojë një shqetësim”.³⁶

Pavarësisht klimës së krijuar, masat represive ndaj shqiptarëve të Greqisë shtoheshin. Në shkurt 1926, qeveria greke pajisi me pasaporta udhëtimi banorët e Gardhiqit e Dragumit për t’i larguar në Turqi. Qeveria shqiptare, për këtë veprim të Athinës më 1 mars, vuri në dijeni sekretarin e LK dhe theksoi se do të detyrohej të merrte të tilla masa ndaj grekofonëve në Shqipëri, çka do të provokonte konflikt midis dy shteteve.³⁷ Kjo e detyroi qeverinë greke të dërgonte pranë LK një delegacion të kryesuar nga ministri i Punëve të Jashtme, Rufos.

³¹ *Po aty*.

³² *AMPJ*, V. 1926, D. 90, fl. 4, Gazeta “Tahi Dhromos”, Aleksandri, 12 janar 1926.

³³ “Shqipëria e Greqia”, në gazetën *Dielli*, 2861 (404), Boston, 12 maj 1925, f. 2.

³⁴ *AMPJ*, V. 1926, D. 68, fl.4, Telegram i M. Frashërit drejtuar MPJ, Athinë, 30 janar 1926.

³⁵ *Po aty*, fl. 29-34, Telegram i M. Frashërit drejtuar MPJ, Athinë, 6 shkurt 1926.

³⁶ *AMPJ*, V. 1926, D. 90, fl. 25, Gazeta “Ethnos”, Athinë, 6 shkurt 1926.

³⁷ *AMPJ*, V. 1926, D. 119, fl. 492. Letër e Mehdi Frashërit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme shqiptare, Gjenevë, 8 prill 1926.

Mehdi Frashëri, në takimin me Rufos, kërkoi: anulimin e largimit të banorëve të Dragumit dhe Gardhiqit; deklarin që të gjithë myslimanët e Çamërisë janë shqiptarë e të pandërrueshëm; suprimimin e nënkomisionit Mikst të Epirit; të drejta për minoritetin çam, ashtu si për shtetasit grekë; rrëzimin e të gjitha masave përjashtuese të marra ndaj tyre deri në atë kohë. Ministri Rufos, në seksionin e minoriteteve të LK deklaroi se pranonte pikat e mësipërme dhe nënshkroi procesverbalin e mbledhjes së 37-të të Këshillit të LK të 10 dhjetorit 1925. Në seksion u dëgjua edhe raporti i delegatit shqiptar dhe ankesat e dërguara nga banorë të komunitetit çam në drejtim të këtij seksioni.³⁸

Në mars 1926, mandatarët e LK në Komisionin Mikst, më në fund deklaruan se popullsia myslimane e Çamërisë në përgjithësi dhe ajo e Dragumit e Gardhiqit kishin origjinë shqiptare dhe ishin të pashkëmbyeshëm. Kryetari i Këshillit të LK, në mbledhjen e 16 marsit 1926, bashkë me përfundimet e Komisionit Mikst, njohu Këshillin edhe me deklaratën e ministrit të PJ të Greqisë bërë para seksionit të minoriteteve.³⁹ Në të njëjtën linjë me deklaratën e Rufos, ishte edhe intervista e Pangallos, e cila u botua e plotë në gazetën “Dielli”. Ai distancohej nga politika që ishte ndjekur ndaj shqiptarëve në Greqi. Persekutimet, ndjekjet, largimet e popullsisë shqiptare në Maqedoni e Epir, i konsideroi masa të papëlqyera të cilat ishin marrë nga ana e organeve inferiore të shtetit dhe nuk përbënin direktivën politike të Greqisë. Ai premtoi se qeveria e tij do të ndëshkonte çdo veprim të keq ndaj shqiptarëve nga ana e disa “kokëgjeshurve të pa përgjegjshëm” dhe se do të respektonte plotësisht detyrimet që rridhnin nga traktatet ndërkombëtare për minoritetet.⁴⁰ Madje, ai e quajti të gabuar teorinë se çdo ortodoks është një grek dhe urdhëroi mbylljen e klubeve vorioepirote, të cilët kishin ngritur veprimtarinë e tyre mbështetur mbi këtë mentalitet. Gjithashtu, Pangallos angazhohej se do të forconte marrëdhëniet ekonomike e tregtare midis Greqisë e Shqipërisë. Siç shihet, deklaratat e tyre shënonin një hap të rëndësishëm madje të guximshëm të politikës greke, si në qëndrimin ndaj shqiptarëve në Greqi ashtu dhe në çështjet thelbësore të politikës së jashtme me Shqipërinë.

³⁸ *Po aty*.

³⁹ *Journal Office de la S.D.N*, prill 1926, f. 511; Dh. Berati, *Shënime historike ...*, f. 51-52.

⁴⁰ “Greqia e Gjeneral Pangallos” në gazetën *Dielli*, 2993 (536), Boston, 30 mars 1926, f. 2; *AMPJ*, V. 1926, D. 90, fl.144-145, Gazeta “Proia”, 20 mars 1926.

Por, politika e qeverisë Pangallos ndaj Shqipërisë, u kritikua jo vetëm nga ekstremistët në atë kohë por edhe në shkrimet e mëvonshme të studiuesve të historisë. Ajo, bashkë me protokollin mbi minoritetet bullgare dhe marrëveshjet me Serbinë, u trajtuan si tre veprime të gabuara të politikës së jashtme të Greqisë në periudhën e pas Luftës së Parë Botërore deri në rrëzimin e Th. Pangallos në gusht të 1926. Veçanërisht deklarata e marsit 1926, në *Enciklopedinë e Madhe Greke*, cilësohej si një goditje e trefishtë për Greqinë. Qeveria greke duke pranuar si të përfunduar procesin e shkëmbimit të popullsive, arsyetohej në *Enciklopedi, së pari*, u hoqi rastin myslimanëve shqiptarë, që konsideroheshin si turq, të shkonin pranë bashkëkombësve të tyre në Turqi; *së dyti*, vijonte arsyetimi, nëpërmjet deklaratës së marsit u kufizua mundësia e vendosjes së muhaxhirëve grekë dhe, *së treti*, ajo u bë pengesë për përpjekjet universale të kombëtarizimit të shtetit grek, pasi pengoi largimin e 20 mijë të huajve (nënkupto shqiptarë - F.M), të cilët do të përdroreshin si kundërbalancim për helenizimin e Epirit të Veriut.⁴¹

Qëndrimi i Athinës u përshëndet nga A. Zogu, i cili në intervistën dhënë për gazetën “Eleftheros Tipos” theksonte se: “Shqipëria kurrë nuk do të harrojë politikën e sinqertë të qeverisë Pangallos dhe do të përpigemi dhe ne të japim prova të padiskutueshme të vullnetit tonë të mirë”⁴².

Me gjithë dëshirën e mirë për një politikë miqësore me Shqipërinë që karakterizoi shtetarët grekë me origjinë arvanitase, Pangallos, Rufos, Kunduriotis, Kondulis, sipas profesor Paskal Milos ata “ nuk mund të kapërcenin unin e tyre të tjetërsuar, gjithë atë mal të madh të paragjytimeve e pretendimeve tradicionale greke ndaj vendit të tyre të origjinës”.⁴³ Për këtë arsye, vullneti i mirë i qeverisë greke mbeti vetëm në kuadrin e premtimeve. Ato nuk ndikuan në politikën e përgjithshme të shtetit grek si në çështjen çame ashtu edhe në pretendimet për Vorio

⁴¹ “Çështja e myslimanëve të Epirit dhe të Thrakës Perëndimore”, në *Enciklopedia e Madhe Greke “Pirsos”*, vëll. X, f. 620-621, Kolona 3-1 (Sipas përkthimit në *Arkivin e Institutit të Historisë* (më tej: *AIH*), A.V. 80); Δημητρη Μιχαλοπουλο, *Ι ελληνικη πολιτικη στο βορειοπειροτικο ζιτιμα*, Αθινα: 1992, σ. 271-280 (Dhimitri Mihalopulu, *Politika greke në çështjen e Vorio-Epirit*, ribotim nga procesverbalet e Kongresit II shkencor Panhelenik “Çështja e Vorioepirit”, Konicë 23-26 gusht 1990, Athinë: 1992, marrë në Bibliotekën e Parlamentit Grek).

⁴² *AMPJ*, V. 1926, D. 90, fl. 152-154, Gazeta “Eleftheros Tipos”, Athinë, 23 maj 1926; P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë ...*, f. 746.

⁴³ P. Milo. *Politika e Jashtme e Shqipërisë ...*, f. 748.

Epirin. Ajo nuk shfuqizoi masat e kundërligjshme që vazhdonin të zbatoheshin ndaj shqiptarëve. Sipas konsullit shqiptar në Korfuz, në burgjet greke që prej vitit 1912, mbaheshin pa vendime gjyqësore 110 shqiptarë të krahinave të ndryshme. Ata akuzoheshin për krime ndaj të krishterëve dhe si propagandistë turbullues gjatë pushtimit grek të Shqipërisë së Jugut në vitin 1914⁴⁴. Ndërkohë vazhdoi rekrutimi me forcë në ushtri të djemve çamë, të pajisur me certifikata.⁴⁵ Autoritetet vendore pa përfillur deklaratën e qeverisë ushtronin presion mbi popullsinë çame, për të mos kërkuar të drejtat si minoritet, në të kundërt ata do të internoheshin.⁴⁶

Në këto rrethana, qeveria shqiptare dërgoi në Athinë një delegacion për t'u njohur konkretisht me gjendjen e shqiptarëve në Greqi dhe për të biseduar me qeverinë greke për përmirësimin e saj, por pa rezultat.⁴⁷ Gjithashtu, ajo shfrytëzoi edhe vizitën e sekretarit të Përgjithshëm të LK, Erik Drymond, më 16 prill në Athinë, të cilit nëpërmjet legatës shqiptare i kërkoi zbatimin nga qeveria greke të deklaratave të bëra në Këshillin e LK.⁴⁸

Veç këtyre masave, qeveria shqiptare vijoi përpjekjet për të tërhequr Athinën në bisedime për traktatin e nënshtetësisë, atë konsullor e të vendbanimit. Për këtë ajo shfrytëzoi edhe interesimin e qeverisë greke për shqiptarët me nënshtetësi greke të marrë para vitit 1913, të cilëve autoritetet shqiptare u kishin refuzuar pajisjen me dokumente pronësie mbështetur në ligjin otoman të nënshtetësisë të 21 shkurtit 1883.⁴⁹ Ky ligj i cili qëndroi në fuqi në Shqipëri edhe gjatë viteve të Republikës (1925-1928), u mohonte atyre të drejtën e pronës dhe të trashëgimisë në vendet e origjinës.⁵⁰ Në përgjigjen e tij, ministri i Punëve të Jashtme Hysen

⁴⁴ *AMPJ*, V. 1926 D. 63, fl.71-72, Telegram i konsullit shqiptar Qemal Frashëri drejtuar MPJ, Korfuz, 26 prill 1926.

⁴⁵ *AQSH*, F. 152, V. 1926, D. 111, fl. 4, Telegram i nënprefekturës së Delvinës drejtuar MPB, Delvinë, 8 korrik 1926.

⁴⁶ *Po aty*, fl.1, Telegram i prefekturës së Gjirokastrës drejtuar MPB, Gjirokastrë, 22 maj 1926.

⁴⁷ *AMPJ*, V. 1925, D. 32, fl. 156, Telegram i MPJ drejtuar M. Frashërit, Tiranë, 22 dhjetor 1925.

⁴⁸ *Po aty*, V. 1926, D. 119, fl. 504, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, 17 prill 1926.

⁴⁹ *Po aty*, V. 1926, D. 36, fl. 1, Telegram i MPB drejtuar MPJ, Tiranë, 22 maj 1926.

⁵⁰ *Po aty*, V. 1926, D. 38, fl. 47, Ligji otoman i nënshtetësisë me titull, "Mbi kapacitetin e një nënshtetasi otoman i natyralizuar i huaj", theksonte: Ata, të cilët pa marrë

Vrioni, sqaronte se këto çështje mund të zgjidheshin vetëm me një marrëveshje përfundimtare nënshtetësie.⁵¹ Mbështetur në interesin e dyanshëm, ai zhvilloi bisedime me legatën greke në Durrës për dërgimin e delegacionit zyrtar në Athinë, për nënshkrimin e traktateve.⁵²

Pas përgjigjes pozitive të Athinës, delegacioni shqiptar i përbërë nga Mehdi Frashëri, Xhaferr Ypi, Milto Tutulani, Kol Thaçi dhe Fejzi Alizoti, në fillim të korrikut 1926 mbërriti në Greqi dhe filloi punën për përgatitjen e projektit të traktatit mbi nënshtetësinë dhe me studimin e tarifave konvencionale që do të shërbenin për traktatin e tregtisë midis dy vendeve.⁵³

Në bisedimet midis delegacioneve, pala shqiptare kërkoi që çështja e nënshtetësisë të trajtohej e para. Delegacioni shqiptar pasi studioi propozimet e palës greke, më 17 korrik, paraqiti kundërpropozimet e tij. Ai kërkoi:

a) 15 mijë shqiptarët e ardhur në Greqi nga Shqipëria e pavarur që nuk kishin familje, të mbanin nënshtetësinë shqiptare;

b) Shqiptarët me banim të përhershëm në Greqi para korrikut 1913, të konsideroheshin nënshtetas grekë me të drejtë optioni (kërkesë) për nënshtetësi shqiptare;

c) Ata me banim të përhershëm në Greqi pas vitit 1913 deri në 1920, të konsideroheshin nënshtetas shqiptarë me të drejtë optioni për nënshtetësi greke;

d) Shqiptarët me banim në Greqi, nga vitit 1920 të konsideroheshin nënshtetas shqiptarë, pa pranuar asnjë option për ta;

e) Shqiptarët që kishin shërbyer në ushtrinë greke si oficerë aktivë ose në pension, për arsye politike, u cilësuan grekë.⁵⁴

autorizimin e qeverisë (otomane) e kanë humbur të drejtën e nënshtetësisë otomane, të drejtën e pronës e të trashëgimit dhe pasuria e tyre sipas art. 3 të këtij ligji, u ndahej trashëgimtarëve të tyre që ishin nënshtetas otomanë.

⁵¹ *Po aty*, V. 1926, D. 36, fl. 5, Telegram i MPJ drejtuar MPB, Tiranë, 16 qershor 1926.

⁵² *Po aty*, V. 1926, D. 57, fl. 140, Telegram i MPJ, drejtuar konsullit shqiptar në Selanik, Tiranë, 15 maj 1926.

⁵³ *Po aty*, V. 1926, D. 7, fl. 40, Telegram i Këshillit të Ministrave drejtuar MPJ, ku bëhej me dije për vendimin nr. 199 të Këshillit të Ministrave, Tiranë, qershor 1926; *Po aty*, V. 1926, D. 68, fl.87, Telegram i legatës shqiptare drejtuar MPJ, Athinë, 18 korrik 1926.

⁵⁴ *Po aty*, V. 1926, D. 68, fl. 87, Telegram i legatës shqiptare drejtuar MPJ, Athinë, 18 korrik 1926.

Gjatë bisedimeve pala greke u përpoq të mbronte propozimet e veta duke u mbështetur në traktatin e Athinës të vitit 1913, atë të Sevres dhe të Lozanës. Delegacioni shqiptar i kundërshtoi dhe argumentoi për secilin se ata nuk kishin efekte juridike mbi shtetin e pavarur shqiptar.⁵⁵ Ndër të tjera, pala greke kërkoi që shqiptarët me banim në vende të ndryshme si në Egjipt, Rumani, SHBA, etj, që kishin marrë nënshtetësi greke, të njiheshin si grekë. Por kjo nuk u pranua nga qeveria shqiptare, me arsyetimin se çështja do të rregullohej me konventa dypalëshe me shtetet përkatëse, ashtu siç ishte vepruar me Turqinë në vitin 1925.⁵⁶ Delegacioni shqiptar bëri përpjekje që kundërpropozimi në vija të përgjithshme, të mbetej i pandryshuar. Për të krijuar një frymë sa më bashkëpunuese në bisedime, Mehdi Frashëri i tërhoqi vëmendjen qeverisë shqiptare për miratimin e ligjit që ndalonte hyrjen e punëtorëve të huaj në Shqipëri. E quajti atë të pavend dhe të dëmshëm për punëtorët shqiptarë jashtë vendit, të cilët ishin më të shumtë në numër, krahasuar me punëtorët e huaj, të cilët për kushtet ekonomike që ofronte Shqipëria ishin të papërfillshëm. Qeveria greke si kundërveprim ndaj tij, nxori nga puna disa mijëra shqiptarë, prandaj ai i kërkoi qeverisë së tij anulimin sa më shpejtë të tij. Gjithashtu propozoi përgatitjen e një projektligji për t'i njohur të drejtën e trashëgimisë nënshtetasve grekë me origjinë shqiptare në Korçë, për të mos i dhënë shkak qeverisë greke për t'u nxjerrë vështirësi pronarëve shqiptarë në Greqi.⁵⁷

Ruajtjen e postit të ministrit të Punëve të Jashtme nga Rufos në qeverinë e re greke të Athanasios Eftaksias, M. Frashëri e shihte si pozitive për vijueshmërinë e bisedimeve. Delegacioni shqiptar shfrytëzoi pritjen e organizuar prej tij, për t'i kërkuar përsheptimin e bisedimeve për marrëveshjen e nënshtetësisë për kapërcimin e disa pikave të papërfunduara, pajisjen me certifikata të pronarëve shqiptarë të pashkëmbyeshëm që të lejoheshin të ktheheshin në Greqi për të shfrytëzuar pronat e tyre dhe i dorëzuan tarifatat doganore për mallrat shqiptare që hynin në Greqi, të domosdoshme për përfundimin e

⁵⁵ *Po aty*, V. 1926, D. 57, fl. 167, Telegram i legatës shqiptare drejtuar MPJ, Athinë, 15 gusht 1926.

⁵⁶ *Po aty*, V. 1926, D. 57, fl. 210, Vendimi nr 259 i Këshillit të Ministrave iu përcoll legatës shqiptare në Athinë, Tiranë, 5 gusht 1926.

⁵⁷ *Po aty*, V. 1926, D. 68, fl. 87, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ në Tiranë, Athinë, 18 korrik 1926.

marrëveshjes së tregtisë.⁵⁸ Gjithashtu L. Kurti i ngriti çështjen e riaktivizimit të klubit vorioepirot të Korfuzit. Rufos i kërkoi atij që t'i transmetonte MPJ të Shqipërisë mendimin e tij, për lidhjen e një akordi politik midis dy vendeve, që do të shërbente për t'u prerë udhën edhe intrigave të kundërshtarëve dhe personave me ngarkesa shoviniste, që ndikonin në prishjen e marrëdhënieve miqësore midis dy vendeve.⁵⁹ Duket se një kërkesë e tillë, veç interesit të mësipërm, bëhej edhe si kundërpeshë e presionit të Italisë ndaj Shqipërisë për realizimin e një pakti të tillë, si dhe për tërheqjen e Shqipërisë në përpjekjet e shteteve ballkanike, për krijimin e aleancave dy ose më shumë palëshe. Dokumentet e konsultuara deri më sot nuk japin ndonjë qëndrim të qeverisë shqiptare ndaj këtij propozimi të Athinës, për shkak të bisedimeve me Italinë dhe çdo lëvizje e saj në këtë drejtim do të sillte reagimin e Musolinit, i cili politikën shqiptare të Italisë nuk dëshironte ta ndante me askënd.

Miqësia e afruar ndaj Shqipërisë në këtë periudhë, nuk dha shenja në përmirësimin e gjendjes së banorëve të Çamërisë. Kjo dëshmohej në ankesat e shumta të banorëve të Çamërisë. “Persekutimet janë kaq të këqia, theksohej në një rën prej tyre, sa çamërit nuk mund të durojnë më”.⁶⁰ Nisur nga kjo gjendje, L. Kurti theksonte se: “dëshira e sinqertë e miqësisë me Shqipërinë është vetëm te zoti Pangallos, Rufos e Kondulis. Shumica e madhe e oficerëve dhe sidomos e autoriteteve vendore, është krejt ndryshe. Nuk di se kjo dëshirë e të parëve sa dhe kur mund të realizohet”.⁶¹

Pas bisedimeve të gjata, në gusht 1926 u përfundua traktati i nënshtetësisë.⁶² Sipas tij, palët pranonin nënshtetësinë reciproke të banorëve me origjinë shqiptare në Greqi e të atyre me nënshtetësi greke në Shqipëri, mbështetur në kriteret e përcaktuara në marrëveshje.

⁵⁸ *Po aty*, fl. 92-94, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ në Tiranë, Athinë, 22 korrik 1926.

⁵⁹ *Po aty*, fl. 95-96, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ në Tiranë, Athinë, 24 korrik 1926.

⁶⁰ *Po aty*, fl. 92-94, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ në Tiranë, Athinë, 22 korrik 1926.

⁶¹ *Po aty*.

⁶² *AMPJ*, V. 1926, D. 57, fl. 167, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ në Tiranë, Athinë, 15 gusht 1926; *po aty*, fl. 169, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ në Tiranë, Athinë, 5 gusht 1926.

Në marrëveshje shqiptarët me banim në Greqi, ndaheshin në 3 kategori:

1) Ata shqiptarë që kishin ndërruar nënshtetësinë otomane dhe kishin marrë atë greke para se të krijohej shteti shqiptar si dhe ata që ndodheshin si oficerë aktiv ose në pension, njiheshin si nënshtetas grekë.

2) Shqiptarët me banim në provincat e aneksuara Greqisë, para dhe pas vitit 1913 deri më 6 gusht 1924, kishin të drejtë optioni deri në 8 muaj mbas ratifikimit të marrëveshjes. Të gjithë shqiptarët që kishin paraqitur kërkesën për nënshtetësi shqiptare, sipas urdhrin të qeverisë greke në mars 1925, meqenëse optioni i tyre ishte i vlefshëm, konsideroheshin shqiptarë.

3) Njiheshin si shqiptarë pa asnjë pengesë: a) Ata që banonin pa familjet e tyre në Greqi, kudo që ndodheshin dhe në çdo datë që kishin hyrë; b) Ata që kishin hyrë në Greqi pas datës 6.8.1924 dhe banonin aty; c) Shqiptarët me banim në Greqinë e vjetër me familjet e tyre para vitit 1913, veç atyre që kishin ndërruar nënshtetësinë otomane me nënshtetësinë greke.⁶³ Shqiptarët që kishin ndërruar nënshtetësinë otomane para 1913-ës dhe kishin marrë atë greke, duhej të paraqitnin dokumentin e regjistrimit të tyre jo vetëm nga arkivat e shtetit civil të komunave ku banonin, por të ishin regjistruar edhe në matrikullin ushtarak.⁶⁴

Neni 2 dhe 4 i marrëveshjes u njihte të drejtën nënshtetasve grekë me origjinë shqiptare në Greqi dhe nënshtetasve shqiptarë me origjinë greke në Shqipëri, të kërkonin nënshtetësi shqiptare apo greke, një vit pas shkëmbimit dhe ratifikimit të marrëveshjes dhe, nëse u miratohej nga qeveria përkatëse, ata brenda tre viteve duhej të linin vendin. Njohja e të drejtës për option dhe përcaktimi i afateve kohore për veprim, pati rëndësi se mbronte nënshtetasit nga veprimet arbitrare të autoriteteve shtetërore.

Me interes të dyanshëm ishte neni 6, në të cilin përcaktohej se nënshtetasit grekë me origjinë shqiptare në Greqi, përfshirë edhe ata persona të natyralizuar si grekë, të vendosur para 1913-ës, si dhe nënshtetasve shqiptarë me origjinë greke në Shqipëri, u njihte të drejtën

⁶³ *Po aty*, V. 1926, D. 57, fl. 173-175, Shpjegime mbi marrëveshjen e nacionalitetit midis Shqipërisë e Greqisë, Athinë, 13 tetor 1926.

⁶⁴ *Po aty*, fl. 247, shih edhe në: Marrëveshja e nënshtetësisë midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë; *Enciklopedia e Madhe Greke "Pirsos"*, vëll. V, f. 613 (Sipas përkthimit në *AIH*, A.V.78).

të udhëtonin lirisht në tokën e shtetit tjetër për punë tregtare, etj.; të qëndronin, të ruanin, të dispononin e të vepronin lirisht pasurinë e luajtshme e të paluajtshme në qytet dhe me pasuritë bujqësore të fituara më parë, që trashëgonin me testament ose pa testament prindërit e tyre, ose persona të tjerë nënshtetas shqiptarë apo grekë, t'i shisnin ato sipas procedurave të përcaktuara në ligjet e secilit shtet.⁶⁵

Zbatimi i marrëveshjes do t'i jepte fund praktikave të ndjekura deri në atë kohë nga qeveria greke që synonte t'u mohonte shqiptarëve origjinën, t'i konsideronte ata nënshtetas grekë ose turq në bazë të sistemit të Mileteve dhe të traktateve që shqiptarët nuk kishin të bënin me to.

Pas kësaj, delegacioni u përqendrua në çështjen e pasurive të shqiptarëve në Greqi, e cila u trajtua herë pas here me autoritetet greke. Fillimisht delegacioni hartoi dy memorandume dhe i depozitoi në komisionin e traktateve të MPJ greke. Në varësi të përgjigjes të qeverisë greke dhe parimeve të përcaktuara, do të fillonin bisedimet që do të formonin bazën për marrëveshjen mbi pasuritë.

Pas afro katër muaj bisedimesh, më 13 tetor 1926, u nënshkruan disa marrëveshje si ajo e nënshtetësisë, konsullore dhe e vendbanimit, e tregtisë dhe ekstradimit. Nisur nga rëndësia që kishin ato për zgjidhjen edhe të çështjes së pasurive të shqiptarëve në Greqi, Parlamenti shqiptar i ratifikoi në nëntor 1926 dhe në dhjetor të atij viti u dekretuan nga Presidenti i Republikës.⁶⁶ Ndërsa, qeveria greke, pikërisht për këtë arsye, ratifikimin e konventave e shtyu për një kohë të gjatë, madje edhe pas ratifikimit (veç asaj konsullore e të vendbanimit) nga legjislativi i të dy shteteve, ajo nuk bëri shkëmbimin e tyre.⁶⁷ Kjo i shërbeu Athinës për të shtyrë bisedimet për rregullimin e pasurive të shqiptarëve në Greqi dhe për spastrimin etnik të Çamërisë. Madje, qarqe antishqiptare vorioepirote dhe ekstremistë të tjerë grekë, për të penguar bisedimet për zgjidhjen e çështjes së pasurive filluan sulmin ndaj përfaqësuesit grek në Shqipëri Kondulis, i cili kishte kontribuar në përmirësimin e marrëdhënieve midis

⁶⁵ AMPJ, V. 1926, D. 57, fl. 247, Shpjegime mbi marrëveshjen e nacionalitetit midis Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Greqisë.

⁶⁶ AMPJ, V. 1926, D. 7, fl. 86, Telegram i MPJ drejtuar legatës shqiptare në Athinë, Tiranë, 27 dhjetor 1926; *po aty*, V. 1926, D. 89, fl. 52, Telegram i ministrit të Punëve të Jashtme, Hysen Vrioni, drejtuar Këshillit të Ministrave, Tiranë, 6 nëntor 1926.

⁶⁷ *Po aty*, V. 1926, D. 119, fl. 650, Letër e ministrit të Punëve të Jashtme të Shqipërisë drejtuar sekretarit të Përgjithshëm të LK, Tiranë, mars 1928.

dy vendeve dhe mbarëvajtjen e bisedimeve për nënshkrimin e traktateve. Ata kërkuan shkarkimin nga detyra e dërgonin e tij para drejtësisë.⁶⁸ Akuzat ndaj tij kishin gjetur mbështetje edhe nga deputeti i parlamentit shqiptar M. Kaso, i cili kishte intriguar kundër tij, pranë Presidentit dhe ministrit të PJ të Greqisë. Qenien e tij në detyrë, Mehdi Frashëri e shihte të nevojshme edhe për shkak të premtimeve që ai kishte bërë për të ndihmuar në zgjidhjen e çështjes së pasurive të shqiptarëve në Greqi.⁶⁹

Bisedimet për marrëveshjen mbi pasuritë e shqiptarëve, po zvarriteshin nga pala greke. Veç mungesës së vullnetit të Athinës, për këtë ndikoi dhe situata e paqëndrueshme politike në Greqi për shkak të zgjedhjeve që do të zhvilloheshin në tetor 1926. Prandaj, në fund të tetorit 1926, delegacioni shqiptar u kthye në Tiranë.⁷⁰

Gjendja në Çamëri pas nënshkrimit të marrëveshjeve

Pas nënshkrimit të marrëveshjeve të nënshtetësisë, asaj konsullore dhe të vendbanimit, të tregtisë dhe të ekstradimit gjendja e popullsisë shqiptare në Çamëri nuk pësoi ndryshim. Shpronësimi i shqiptarëve u shtri edhe në pronat e përjashtuara me ligj nga ky proces dhe në kundërshtim me marrëveshjet e nënshkruara. Banorë të Karaferisë, megjithëse nuk ishin pjesë e shkëmbimit të popullsisë, u detyruan të shisnin pronat e të largoheshin në Turqi. Të dhëna të tjera dëshmonin për veprime të kundërligjshme të autoriteteve greke ndaj tregtarëve dhe biznesmenëve shqiptarë. Për t'ua bërë të pamundur qëndrimin në Greqi, vazhdonin të rekrutonin shqiptarët duke përfshirë edhe ata të moshës 50 vjeç (deri në 4 muaj), në të kundërt ata paguanin një shpërblim i cili shkonte deri në 3000 dhrahmi. U kërkonin banorëve të paguanin taksë kapitali që shkonte 6 deri 10 fishin e shumës, e cila u jepej si shpërblim për pronat e shpronësuara dhe në pamundësi për ta likuiduar, detyroheshin t'u shisnin shtëpitë refugjatëve grekë dhe kështu të linin shtëpitë e tyre.⁷¹

⁶⁸ *Po aty*, V. 1926, D. 68, fl.120-122, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ në Tiranë, Athinë, 5 shtator 1926.

⁶⁹ *Po aty*, V. 1926, D. 89, fl. 13, Telegram i Mehdi Frashërit, drejtuar MPJ, Athinë, 27 korrik 1926.

⁷⁰ *Po aty*, V. 1926, D. 6/1, fl. 248, Telegram i MPB, drejtuar MPJ, Tiranë, 21 tetor 1926.

⁷¹ *Po aty*, V. 1927, D. 44, fl .77, Telegram i Kryesisë së Senatit, drejtuar kryesisë së KM, Tiranë, 30 maj 1927.

Gjendja e vështirë dhe diskriminuuese e shqiptarëve në Çamëri, shtrihej edhe në aspektin e të drejtave politike, shoqërore e kulturore. Madje dhe besimi i tyre nuk respektohej. Në qytetin e Janinës ku banonin 400 shqiptarë myslimanë, nuk kishte asnjë xhami, nga 20 të tilla që kishin ekzistuar në Perandorinë Osmane. 400 të rinjve që kryenin shërbimin ushtarak në Janinë, nuk u ishte lejuar për të pasur imamin e tyre, ashtu siç ishte vepruar me izraelitët që, megjithëse më të pakët në numër, u ishte njohur kjo e drejtë. Shqiptarët myslimanë nuk kishin tokë për të varrosur të vdekurit, të cilët detyroheshin t' i dërgonin në Delvinë.⁷²

Banorët e Çamërisë i kërkuan qeverisë shqiptare, si anëtare e LK dhe me shtete miq, t'u mbronte të drejtat dhe të krahasonte gjendjen e tyre me atë të grekofonëve në Shqipëri, ndërsa qeverisë greke i kërkuan njohjen e të drejtës për të shfrytëzuar pronat të cilat i kishin me tapi. Për shkak të kësaj politike theksonin ata, "...elementi shqiptar këtu pak nga pak po zhduket".⁷³ Athina nuk ndërmoi asnjë hap për të realizuar premtimet para LK për kthimin e banorëve të Dragumit e të Gardhiqit në shtëpitë e tyre. Ajo vendosi që edhe 24 familje të Pargës të cilat kishin kërkuar nënshtetësi greke dhe kishin kryer shërbimin ushtarak, së bashku me 500 familje të tjera çame, t'i konsiderojë si turq të shkëmbyeshëm dhe urdhëroi Bankën Kombëtare t'ua blinte pasuritë.⁷⁴ Qeveria turke në janar 1927, njoftoi Athinën se nuk mund të pranonte çamët në Turqi, sepse çështja e shkëmbimit të popullsisë ishte mbyllur në LK.⁷⁵

Qeveria shqiptare, nisur nga situata e vështirë brenda vendit dhe ashpërsimi i marrëdhënieve me Jugosllavinë, në fund të vitit 1926 dhe fillim të 1927-ës, u detyrua të ishte e kujdesshme për mos acaruar

⁷² *Po aty*, V. 1927, D. 130, fl.73-74, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, 5 korrik 1927.

⁷³ *Po aty*, fl. 8, Telegram i legatës shqiptare drejtuar ministrit të Punëve të Jashtme, H.Vrioni, Athinë, 4 janar 1927; *po aty*, fl. 44, Telegram i legatës shqiptare drejtuar MPJ, Athinë, 8 prill 1927; *po aty*, V. 1927, D. 44, fl. 59, Telegram i MPB drejtuar MPJ, Tiranë, 5 maj 1927.

⁷⁴ *Po aty*, V. 1926, D. 68, fl. 120-122, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, 5 shtator 1926; *po aty*, V. 1926, D. 119, fl. 634, Telegram i kryekonsullit shqiptar në Janinë drejtuar legatës shqiptare në Athinë, Janinë, 28 nëntor 1926; *po aty*, V. 1927, D.130, fl.102, Telegram i legatës shqiptare drejtuar MPJ, Athinë, 22 korrik 1927.

⁷⁵ *AMPJ*, V. 1927, D. 130, fl. 15, Telegram i konsullit shqiptar në Stamboll drejtuar MPJ, Stamboll, 23 janar 1927.

marrëdhëniet me Greqinë. Ministri i Jashtëm këshilloi ministrin Fuqiplotë shqiptar në Athinë, për vazhdimin e përpjekjeve miqësore pranë qeverisë greke në trajtimin e problemeve të minoritetit çam. Nga ana e saj qeveria do të vazhdonte përpjekjet pranë legatës greke në Shqipëri, për të kërkuar realizimin e premtimeve të saj ndaj popullsisë shqiptare.⁷⁶ Megjithatë Parlamenti shqiptar në fund të majit 1927, diskutoi gjendjen e popullsisë çame dhe i kërkoi qeverisë të ndërhynte pranë autoriteteve greke për të ndaluar shpronësimet e shqiptarëve dhe t'u kërkonin që marrëveshja e përfunduar me qeverinë angleze për tokat rurale të aplikohet edhe për shqiptarët, pasi dhe marrëveshjet e nënshkruara me Shqipërinë ishin bërë mbi parimin e kombit më të favorizuar.⁷⁷

E ndodhur nën presionin e vazhdueshëm të qeverisë shqiptare dhe për të shkuar në mbledhjen e radhës të Këshillit të LK me një "bilanc pozitiv" në marrëdhëniet me Shqipërinë, Parlamenti grek futi në procedurë ratifikimin e konventës së nënshtetësisë, ekstradimit duke lënë jashtë marrëveshjen konsullore e të vendbanimit.⁷⁸ Kjo shqetësoi Tiranën dhe opinionin publik shqiptar sepse lidhej me zgjidhjen e çështjes së pasurive. Ministri i Punëve të Jashtme porosi legatën shqiptare, t'i kërkonte shpjegime Athinës mbi arsyet e mosratifikimit të këtij traktati dhe të bënte një përlllogaritje të përafërt të vlerës së pasurive të shqiptarëve sipas listave të dërguara nga Tirana, duke shtuar edhe pasuritë e shqiptarëve që banonin aktualisht në Greqi.⁷⁹ Ministri i Jashtëm grek, Mihalakopoulos veprimin e Parlamentit e justifikoi me pamundësinë financiare të Greqisë, duke shpresuar se me sigurimin e një huaje financiare nga Gjeneva dhe shtetet e tjera të fuqishme, do të bënte të mundur pagesën e pasurive të shqiptarëve.⁸⁰ Lidhur me faturën financiare, ai i kërkoi qeverisë shqiptare të ishte më racionale në kërkesat e saj dhe të mos i referohej marrëveshjes me anglezët, sepse të gjithë të

⁷⁶ *Po aty*, fl.10, Telegram i MPJ drejtuar legatës shqiptare në Athinë, Tiranë, janar 1927.

⁷⁷ *AQSH*, F. 146, V. 1927, D. 93, fl. 173-174, Sipas procesverbaleve të Parlamentit, 30 maj 1927.

⁷⁸ *AMPJ*, V. 1927, D. 102, fl. 20, Telegram i Stavri Stavrit drejtuar MPJ, Athinë, 27 maj 1927.

⁷⁹ *Po aty*, fl. 25, Telegram i MPJ drejtuar legatës shqiptare në Athinë, Tiranë, 30 maj 1927.

⁸⁰ *Po aty*, fl. 28-38, Telegram i Stavri Stavrit drejtuar MPJ, Athinë, 31 maj 1927.

huajt së bashku, nuk kishin më shumë se 200 mijë strema (hektarë) në Greqi, ndërsa shqiptarët kishin 4 herë më shumë.⁸¹

Në korrik 1927, kapërcimi i krizës me Jugosllavinë dhe stabilizimi i jetës politike në vend, i krijoi mundësi qeverisë shqiptare të intensifikonte veprimin diplomatik në mbrojtje të të drejtave të shqiptarëve në Greqi. Iljaz Vrioni, në atë kohë ministër i Punëve të Jashtme i kërkoi përfaqësuesit grek në Shqipëri vëmendje më të madhe nga ana e Athinës zyrtare për zgjidhjen e këtyre problemeve dhe iu lut t'u jepte atyre në një kohë të shpejtë zgjidhje të kënaqshme.⁸² Në të njëjtën kohë, ai nxiti shtypin të pasqyronte gjendjen e minoritetit shqiptar në Greqi, shkeljen e të drejtave të tyre politike, ekonomike, kulturore dhe në mënyrë krahasuese të evidentonte politikën e shtetit shqiptar ndaj minoritetit grek në Shqipëri, madje, të mbante qëndrim kritik ndaj politikës së ndjekur nga qeveria shqiptare deri në atë kohë.⁸³ Tirana zyrtare i drejtoi një letër qeverisë greke më 4 korrik, ku i kërkoi ratifikimin e konventës konsullore e të vendbanimit për t'i dhënë sa më shpejt zgjidhje çështjes së pasurive.⁸⁴ Qeveria greke deklaroi se do të ratifikonte marrëveshjet e nënshkruara, përveç asaj konsullore e të vendbanimit, sepse ajo u siguronte shqiptarëve lehtësirat që ofronte artikulli 3, në bazë të të cilit, në rast rekuizimi ose shpronësimi të pasurive të shqiptarëve në Greqi, ata do të gëzonin trajtimin e kombit më të favorizuar. Qeveria shqiptare i kërkoi edhe kryeministrit Kunduriotis të ndërhynte në zgjidhjen e kësaj çështjeje. Ajo nga ana e saj, do të bindte pronarët shqiptarë të hiqnin dorë nga dëmshpërblimi me para në dorë ashtu si anglezët, por ata duhej të siguroheshin me garancinë e një banke për pagesën e tyre. Kundërshtimi i Athinës, kushtëzohej edhe nga gjendja e vështirë ekonomike dhe paqëndrueshmëria politike në vend, që nuk e

⁸¹ *Po aty*, fl. 34. Dokumenti është pa datë. Mendohet se ai është para nisjes së delegacionit grek në Gjenevë në qershor 1927.

⁸² *AMPJ*, V. 1927, D. 82, fl. 20, Telegram i MPJ drejtuar legatës shqiptare në Athinë, Tiranë, 4 korrik 1927.

⁸³ *Po aty*, V. 1927, D. 130, fl. 61-62, Njoftim i Drejtorisë së Shtypit drejtuar disa gazetave shqiptare, Tiranë, 6 korrik 1927

⁸⁴ *Po aty*, V. 1927, D. 44, fl. 111, Letër e ministrit Kurti drejtuar ministrit grek të Punëve të Jashtme, Athinë, 18 korrik 1927; shih edhe P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë...*, f. 734.

lejonte qeverinë të merrnin përgjegjësi të tilla për shlyerjen e një fature prej 50 milion franga ar.⁸⁵

Qeveria greke, në fund të korrikut 1927, njoftoi Tiranën zyrtare se pranonte të dëmshpërblente pronarët shqiptarë në të njëjtin nivel si nënshtetasit e saj. Ajo shprehte vullnetin e mirë për të hyrë në bisedime dhe priste propozime konkrete prej qeverisë shqiptare.⁸⁶ Ndryshe nga sa ofronte homologia greke, qeveria shqiptare vendosi që propozimet e saj t'i mbështeste në traktatet e nënshkruara me Athinën dhe në parimet e së drejtës ndërkombëtare. Qëndrimin e saj e bëri të njohur në "Gazeta e Korçës" ku midis të tjerave theksonte se, çështja e pasurive të shqiptarëve në Greqi, ishte çështje shpronësimi nga qeveria greke dhe, sipas të drejtës ndërkombëtare, çdo shpronësim duhej të paguhej menjëherë dhe me vlerën e vërtetë të tij, gjë që nuk ishte realizuar nga qeveria greke për shqiptarët. Prandaj qeveria shqiptare duke u mbështetur mbi këto parime, do të merrte të gjitha masat dhe do të angazhohej për zgjidhjen e kësaj çështjeje.⁸⁷

Çështja e pasurive të shqiptarëve u trajtua përsëri në Parlamentin shqiptar në shtator 1927. Deputetët dënuan politikën e Greqisë për zgjidhjen e kësaj çështjeje kërkuan t'u jepej fund bisedimeve dhe të përdroreshin forma të tjera për të detyruar qeverinë greke për zgjidhjen e këtij problemi. Por A. Zogu ishte i mendimit për vazhdimin e bisedimeve. Ai u zotua, se do të merrte masat e duhura dhe i kërkoi ministrit të Jashtëm të shtonte përpjekjet për një bashkëpunim të mëtejshëm me Athinën për t'i dhënë një përfundim çështjes.⁸⁸

Ndërkohë MPJ i paraqiti Këshillit të Ministrave tekstin me këto propozime:

1. Të gjitha pasuritë e paluajtshme të shqiptarëve që i zotëronin me tapi qysh në kohën e regjimit otoman dhe u ishin marrë nga fshatarët ose njerëz të ardhur nga jashtë, duhej t'u ktheheshin të zotëve;

⁸⁵ *AMPJ*, V. 1927, D. 44, fl. 108, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, 23 korrik 1927.

⁸⁶ *Po aty*, fl. 110, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, korrik 1927.

⁸⁷ *Po aty*, fl. 137, Telegram i MPJ drejtuar redaksisë së "Gazeta e Korçës", 6 shtator 1927, Konvencionet me Greqinë. Aty shprehej qartë qëndrimi i qeverisë shqiptare, për zgjidhjen e çështjes së pasurive të shqiptarëve në Greqi.

⁸⁸ *Po aty*, f. 128, "Gazeta e Korçës" nr. 409, 3 shtator 1927. Pasuritë e shqiptarëve në Greqi

2. Disa pronarë shqiptarë, të cilët për mungesë të mjeteve të jetesës, nuk mund të qëndronin pranë pasurive të tyre dhe u ishin marrë nga ana e qeverisë greke si sende të lëna e pa zot, duhej t'u ktheheshin me gjithë të ardhurat që u përkisnin, të cilat ishin depozituar nga qeveria greke;

3. Kulla, mullinj, hane, dyqane, sharra, kopshte e luadhe, pyje etj., pjesë e çifligjeve në pronësi të shqiptarëve, të cilat sipas ligjit të reformës agrare ishin të pashpronësueshme duhej t'u ktheheshin atyre;

4. Ligji agrar përjashtonte nga shpronësimi një sasi dynmësh për çdo familje. Meqenëse shumica e çifligjeve ishin me shumë fëmijë bashkëpronarë e bashkëtrashëgimtarë, kërkohej t'i lihej pjesë çdo fëmije në çiflig;

5. Të anulohesh sekuestroja e pronave të shqiptarëve myslimanë në Greqi dhe të atyre të vendosur në Shqipëri, të cilët padrejtësisht ishin përfshirë në shkëmbim nga viti 1923;

6. Pasuritë e shqiptarëve të rekuizuara në favor të emigrantëve grekë, të papaguara, qeveria greke, duhet t'ua paguante me çmimet aktuale dhe t'i likuidonte me para në dorë nga huaja që kishte marrë për instalimin e emigrantëve;

7. Shqiptarët për tokat bujqësore të shpronësuara në bazë të ligjit agrar, të paguheshin me vlerën e tregut të ditës dhe me të holla në dorë ashtu si shtetasit anglezë dhe sipas parimit të kombit më të favorizuar⁸⁹.

Për t'i dhënë zgjidhje të lehtë e të dobishme çështjes për të dy palët, qeveria shqiptare propozonte dy mënyra dëmshpërblimi: Të vononte ose të pezullonte për një periudhë 6 vjeçare ligjin agrar dhe gjatë kësaj kohe të lejonte shqiptarët të shisnin lirisht pasuritë bujqësore ose, për çdo stremë të caktohej një vlerë prej dy qeverive e cila mund të ishte edhe 30% më pak nga vlera e vërtetë dhe të përcaktohej sipërfaqja e tokës. Vlera t'u jepej të zotëve në dorë ose, me garancinë e një banke t'u sigurohej pagesa rregullisht për një periudhë 5 vjeçare. Nëse qeveria greke nuk i pranonte propozimet e saj, ajo do t'i drejtohej për ndihmë Fuqive Aleate, Anglisë, Francës, Italisë, si garantë të shtetit shqiptar dhe LK për të kërkuar drejtësi. Nëse këto përpjekje nuk do të jepnin rezultat, MPJ propozonte sekuestrimin e pasurive të nënshtetasve grekë në Shqipëri dhe nëse ato ishin të pamjaftueshme, të sekuestroheshin edhe

⁸⁹ *Po aty*, fl. 140, Propozime të MPJ drejtuar Këshillit të Ministrave, Tiranë, 3 tetor 1927.

ato të grekofonëve.⁹⁰ Pas miratimit nga KM, propozimet iu paraqitën legatës greke në Tiranë.⁹¹

Qeveria greke nuk i pranoi propozimet e Tiranës. Ajo u justifikua se Greqia nuk mund të bënte më shumë për shqiptarët, sesa kishte bërë Rumania për të njëjtën çështje ndaj nënshtetasve grekë, se LK nuk kishte vendosur të drejtën e zhdëmtimit. Ajo i referohej edhe një deklaratë të sekretarit të Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, Austen Chamberlain, i cili ishte shprehur kundër zhdëmtimeve dhe se vlera e madhe financiare e pasurive ishte e papërballueshme për Greqinë.⁹²

Qeveria shqiptare i drejtoi Athinës edhe një here një promemorie, ku i bënte të qartë qëndrimin e saj për pronat, i kërkoi respektimin e të drejtave ndërkombëtare për minoritetin dhe të marrëveshjeve të saponëshkruara midis dy vendeve.⁹³ Në të njëjtën kohë porositi delegacionin shqiptar në Gjenevë, t'ia shtronte çështjen ministrit të Jashtëm grek dhe, nëse e shihte të arsyeshme, gjendja e minoritetit çam t'i bëhej e qartë edhe Sekretarit të Përgjithshëm të LK, E. Colban.⁹⁴ Ministri i Jashtëm grek ashtu si dhe më parë, premtoi se do të merrte masa për kthimin e shtëpive banorëve të fshatrave Gardhiq e Dragumi si dhe hapjen e disa shkollave në minoritetin shqiptar. Ndërsa E. Colban e siguroi se me rastin e vizitës së tij në kryeqytetin grek, më 18 tetor 1927, do të takohej me Stavri Stavrin, përfaqësuesin shqiptar në Athinë dhe do të diskutonte me të për çështjen e çamëve në Greqi dhe të ortodoksëve shqiptarë në Turqi.⁹⁵

Pas kthimit në Athinë, ministri i Jashtëm Mihalakopoulos "harroi" çka premtoi në Gjenevë dhe për çështjen e pasurive, i ofroi ministrit shqiptar në Athinë një zhdëmtim vetëm për 5-6 familje, për të cilat

⁹⁰ *Po aty*, fl. 141.

⁹¹ *Po aty*, fl. 157-158, Memorandum i MPJ drejtuar legatës greke në Tiranë, Tiranë, 31 tetor 1927.

⁹² *Po aty*, fl. 159-167, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, 9 nëntor 1927.

⁹³ *AMPJ*, V. 1927, D. 130, fl. 76, Promemorie drejtuar Legatës greke në Tiranë, gusht 1927.

⁹⁴ *AMPJ*, V. 1927, D. 44, fl.132, Telegram i MPJ drejtuar delegacionit shqiptar në Gjenevë, Tiranë, 27 shtator 1927; *po aty*, V. 1927, D. 130, fl. 77-78, Telegram i MPJ drejtuar delegacionit shqiptar në Gjenevë, shtator 1927.

⁹⁵ *Po aty*, V. 1927, D. 130, fl. 89, Telegram i Xh. Dinos drejtuar MPJ, Gjenevë, 22 shtator 1927; *po aty*, fl. 91, Telegram i MPJ drejtuar "Vatrës" në Boston, Tiranë, 24 shtator 1927.

qeveria shqiptare ishte më e interesuar. Nëse ajo pranonte, ai do të mblidhte qeverinë dhe do t'i jepnin fund çështjes.⁹⁶ Prirja e diplomatit grek për të copëzuar të shpronësuarit dhe për t'i dhënë çështjes drejtim jo zyrtar, dëshmonte qartë vendosmërinë e qarqeve të Athinës për të mos i dhënë zgjidhje përfundimtare e tërësore çështjes dhe për ta futur atë në një rrugë pa krye.

Qeveria shqiptare e bindur se gjendja e minoritetit shqiptar në Greqi dhe ajo e pronave mund të gjente zgjidhje me zbatimin e marrëveshjeve të nënshkruara, ashtu si dhe më parë i kërkoi qeverisë greke, ratifikimin dhe shkëmbimin e tyre. Pala greke e kushtëzoi kërkesën e Tiranës me zgjidhjen e disa çështjeve që sipas saj kishin mbetur pezull, si çështja e tregtarit grek Mollas, ajo e pasurive të nënshtetasve grek në Sarandë, e mësimit të gjuhës greke në minoritet dhe jashtë tij, etj.⁹⁷ Qeveria shqiptare, me anë të një letre sqaronte Athinën se çështjet e mësipërme ajo i kishte trajtuar e rregulluar në bazë të ligjeve të vendit dhe konventave ndërkombëtare.⁹⁸ Pretekstet e Athinës ndaj propozimeve të vazhdueshme të qeverisë shqiptare për të zgjidhur çështjet me bisedime dypalëshe, kishin si qëllim zvarritjen e saj dhe spastrimin etnik të Çamërisë. Në këtë situatë problemi u shtrua përsëri në Parlamentin shqiptar në nëntor 1927, ku u theksua se nëse çështja nuk zgjidhej me bisedime dypalëshe, Shqipëria t'i drejtohej LK.⁹⁹ U propozua të kërkoheshin edhe të drejtat arsimore e politike për popullsinë çame të cilat i garantonte Konventa për minoritetet e LK.¹⁰⁰

Masat represive të ushtruara nga autoritetet greke, detyruan mbi 50 familje çame të hynin në Shqipëri në muajt tetor dhe nëntor.¹⁰¹ Largimin e tyre drejt Shqipërisë shtypi grek e paraqiti si të shtyrë nga propaganda shqiptare për të treguar se minoriteti shqiptar në Greqi gjendej nën masa

⁹⁶ *Po aty*, V. 1927, D. 44, fl. 159-167, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, 9 nëntor 1927

⁹⁷ *Po aty*, V. 1927, D. 102, fl. 39-41, Telegram i Rrok Stanit në legatën shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, 28 tetor 1927.

⁹⁸ *Po aty*, V. 1928, D. 104, fl. 56-57. Dokumenti është pa datë, por nisur nga përmbajtja mendojmë se i takon nëntorit të vitit 1927.

⁹⁹ *AQSH*, F. 146, V. 1927, D. 95, fl. 334, Procesverbale të Parlamentit shqiptar, 30 nëntor 1927.

¹⁰⁰ *Po aty*; Gazeta "Dielli" 4034 (727), 3 janar 1928, f.1.

¹⁰¹ *AMPJ*, V. 1927, D. 130, fl. 167, Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar të ngarkuarit me punë në legatën greke J. Kokotakis, Tiranë, 31 dhjetor 1927; *po aty*, fl. 163, Telegram i MPB drejtuar MPJ, Tiranë, 28 dhjetor 1927.

shtrënguese.¹⁰² Ndërsa qeveria shqiptare e shihte atë si rrezik për t'i dhënë fund ekzistencës së popullsisë çame si minoritet, eliminimin e çështjes së pronave dhe si një shkak për destabilizimin e vendit. Për këtë i drejtoi një notë legatës greke ku tërhoqi vëmendjen për gjendjen e vështirë të popullsisë çame dhe paralajmëroi se nëse do të vazhdonte dëbimi i tyre drejt Shqipërisë, qeveria shqiptare do të gjendej para një situatë të vështirë.¹⁰³

Për t'iu shmangur një ballafaqimi tjetër me shqiptarët në LK, ministri i Jashtëm grek në dhjetor 1927 në Gjenevë, premtoi se me gjithë pretendimet e mëdha të shqiptarëve, do të bënte përpjekje për sheshimin e çështjeve të Çamërisë.¹⁰⁴ Por në realitet qeveria greke nuk hodhi asnjë hap për zgjidhjen e tyre. Kështu, qeveria shqiptare e lodhur me premtime boshe, në fillim të dhjetorit dorëzoi në Sekretarinë e Përgjithshme të LK, ankesën për gjendjen e minoritetit dhe të pasurive të shqiptarëve në Greqi. Ndërkohë, shqiptarët e Çamërisë dhe viseve të tjera të Greqisë nuk i ndërprejnë ankesat drejtuar qeverisë shqiptare, Presidentit të Republikës dhe LK, në të cilat evidentohet presioni i vazhdueshëm i autoriteteve greke ndaj tyre si dhe rreziku që sillte për ta zvarritja e zgjidhjes së çështjes së pasurive.¹⁰⁵

A. Zogu me gjithë sjelljet e Athinës, provoi edhe një herë për të hyrë në bisedime. Ai shfrytëzoi ftesën e J. Kokotaqis, i cili gjatë paraqitjes së letrave kredenciale në fund të vitit 1927, u shpreh se: “qeveria greke do të pranojë me kënaqësi të bisedojë dhe të zgjidhë këtë çështje me anë të një delegacioni shqiptar që do të dërgohej në Athinë”.¹⁰⁶ Mbështetur në propozimin e tij, KM dërgoi një delegacion në Athinë të kryesuar nga Milto Tutulani dhe Xhafer Villa.¹⁰⁷ Me gjithë përpjekjet për të hyrë në bisedime, delegacioni nuk gjeti gatishmërinë e palës greke, e cila i kërkoi të shprehej me shkrim për çështjet e interesuara.¹⁰⁸ Qëndrimin e qeverisë greke ndaj delegacionit shqiptar, gazeta “Nea Ellas” e shpjegonte me

¹⁰² *Po aty*, fl. 94, Gazeta “Qirakis”, Janinë, 7 tetor 1927.

¹⁰³ *Po aty*, fl. 167, Notë e Ministrisë së Punëve të Jashtme drejtuar J. Kokotakis, Tiranë, 31 dhjetor 1927.

¹⁰⁴ *Po aty*, fl. 163, Gazeta “Eleftheron Vima”, 7 dhjetor 1927.

¹⁰⁵ *Po aty*, V. 1928, D. 40, fl. 94, Telegram i konsullit shqiptar në Selanik drejtuar MPJ, Selanik, 8 shkurt 1928.

¹⁰⁶ *Po aty*, V. 1928, D. 10, fl. 175-177, Gazeta “Nea Ellas”, 3 gusht 1928.

¹⁰⁷ *Po aty*, V. 1927, D. 44, fl. 173, Vendim i KM, nr.13, Tiranë, 3 janar 1928.

¹⁰⁸ “Marrëdhëniet me fqinjën e jugut, Greqinë”, në gazetën *Dielli* nr. 4059 (752), Boston, 30 mars 1928.

mungesën e seriozitetit të J. Kokotaqit, i cili nuk kishte qenë i autorizuar prej saj, për një ftesë të tillë.¹⁰⁹

Delegacioni i dorëzoi qeverisë greke dy dokumente dhe u kthye në Tiranë. Në dokumentin e parë trajtoheshin pasuritë rurale. Qeveria shqiptare i kërkonte asaj greke t'i zhdëmtonte shqiptarët e shpronësuar padrejtësisht, sipas mënyrës së vlerësimit dhe procedurës së përcaktuar në konventat e përfunduara për këtë çështje me qeverinë angleze e italiane.¹¹⁰ Detyrimin për trajtimin e njëjtë me ta, ajo e mbështeti në nenin 3 të konventës konsullore e të vendbanimit të përfunduar midis dy shteteve. Aty shprehej gatishmëria e qeverisë shqiptare për të negociuar për një farë zbritje të koeficientit të vendosur në konventat e mësipërme.¹¹¹

Dokumenti i dytë përmbante një përkujtesë konfidenciale, ku vihej theksi për trajtimin e pabarabartë të komunitetit çam krahasuar me nënshtetasit grekë, që dëshmohej në të drejtat civile, politike e kulturore të siguruara prej Kushtetutës e ligjeve greke.¹¹² Me fakte tregohej shpopullimi i Çamërisë. Fshati Gardhiq, me 400 shtëpi, kishte mbetur vetëm me 10-15 shtëpi, Margariti, nga 600 shtëpi në 30. E njëjta pamje sillej edhe për fshatra të tjerë si Dragumi, Karbunarë, etj. Për këto arsye në përkujtesë theksohej se nëse nuk ndryshohej qëndrimi kundrejt çamëve, ata do të linin “votrën e vet shekullore për të gjetur strehë në Shqipëri”.¹¹³ Më tej përmbledheshin kërkesat e popullsisë çame ndaj qeverisë greke për përmirësimin e gjendjes së saj, respektimin e të drejtës së pronësisë dhe zgjidhjen e çështjes së pasurisë se sekuestruar për çamët etj. Në fund të përkujtesës qeveria shqiptare theksonte se, meqenëse

¹⁰⁹ AMPJ, V. 1928, D. 10, fl. 175-177, Gazeta “Nea Ellas”, 23 gusht 1928. Në artikullin e kësaj gazete të titulluar “I ngarkuari me punë i Greqisë dhe turpet e tija”, Kokotaqis cilësohet si i çmendur, kumarxhi, pijanec. Në artikull trajtohet edhe zhgënjimi i A. Zogut, i cili nuk e kishte pranuar asnjëherë në audiencë përfaqësuesin grek, me gjithë kërkesat e përsëritura të tij. Madje A. Zogu kishte deklaruar se “ose unë kam luajtur mendsh, ose Kokotaqis gënjen”.

¹¹⁰ *Po aty*, V. 1928, D. 40, fl. 49-61, Përkujtesë e ministrit fuqiplotë shqiptar në Athinë drejtuar ministrit grek të Punëve të Jashtme, 3 shkurt 1928; shih edhe P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë ...*, f. 765.

¹¹¹ AMPJ, V. 1928, D. 40, fl. 51, Përkujtesë e ministrit fuqiplotë shqiptar në Athinë drejtuar ministrit grek të Punëve të Jashtme, 3 shkurt 1928

¹¹² P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë ...*, f. 757.

¹¹³ *Po aty*.

dëshira e saj për të zgjidhur çështjet e mësipërme me anë të bisedimeve të drejtpërdrejta nuk dha rezultat, ishte e detyruar t'i drejtohej LK.¹¹⁴

MPJ shqiptare, më 1 mars 1928 i drejtoi një letër Sekretarit të Përgjithshëm të LK, E. Colban, në të cilën evidentonte përpjekjet diplomatike të qeverisë shqiptare për të zgjidhur në mënyrë miqësore çështjet për shkëmbim të instrumenteve të ratifikimit të marrëveshjeve të përfunduara për pasuritë e shqiptarëve në Greqi dhe respektimit të të drejtave të minoritetit çam.¹¹⁵ Nëse qeveria greke nuk do të merrte parasysh ankesat e qeverisë shqiptare me një frymë mirëdashëse deri në prill 1928, atëherë Tirana, në detyrim për të mbrojtur interesat e shqiptarëve, në bazë të nenit 11 të Paktit, do ta paraqiste çështjen para Këshillit të LK në Gjenevë.¹¹⁶ Në të njëjtën kohë qeveria u kërkoi edhe përfaqësive diplomatike të Fuqive të Mëdha t'i tërhiqnin vëmendjen qeverisë greke për plotësimin e kërkesave të drejta të paraqitura nga qeveria shqiptare.¹¹⁷ Qeveria italiane e shtyrë nga Tirana zyrtare, për të shmangur diskutimin në LK, ndërhyri pranë Athinës për të rifilluar bisedimet shqiptaro-greke, por pa rezultat. Ministri i Jashtëm turk, T. Ruzhdi si pjesë e problemit të shqiptarëve në Greqi, i theksoi ministrit Fuqiplotë italian në Stamboll, se në këtë çështje, Shqipëria kishte plotësisht të drejtë dhe duhej përkrahur në LK.¹¹⁸ Mbështetja e tij në këtë rast ishte edhe në interes të Turqisë pasi do të frenonte lëvizjen e shqiptarëve myslimanë drejt saj.

Qeveria greke nuk iu përgjigj dy dokumenteve të mësipërme dhe akuzoi qeverinë shqiptare se po ndërhynte në punët e brendshme të Greqisë. Tirana i hodhi poshtë akuzat në mënyrë të argumentuar.¹¹⁹ Duke parë qëndrimin refraktar të Greqisë, MPJ, më 10 prill i kërkoi Sekretarit të Përgjithshëm të LK, që çështja e minoritetit dhe e pasurive të shqiptarëve të shtroheshin për diskutim në sesionin e qershorit të

¹¹⁴ *Po aty*.

¹¹⁵ *AMPJ*, V. 1928, D. 40, fl. 84-87, Letër e Hil Mosit drejtuar sekretarit të Përgjithshëm të LK, 1 mars 1928; *po aty*, fl. 118, Njoftim i sekretarit të Përgjithshëm të LK drejtuar MPJ në Tiranë, Gjenevë, 20 mars 1928.

¹¹⁶ *Po aty*.

¹¹⁷ *Po aty*, fl. 108, Telegram i MPJ drejtuar William Seeds, i dërguar i jashtëzakonshëm dhe ministër Fuqiplotë i Britanisë së Madhe në Durrës, Tiranë, 3 mars 1928.

¹¹⁸ *Po aty*, fl. 138, Telegram i ministrit shqiptar në Angora, R.Fico, drejtuar MPJ, Angora, 15 mars 1928.

¹¹⁹ *Po aty*, fl. 142-146, Përkujtesë e ministrit shqiptar të PJ drejtuar të Ngarkuarit me Punë të Greqisë, Kokotaqis, Tiranë, 21 mars 1928.

Këshillit të LK, konform me artikullin 11 të paktit.¹²⁰ Për të mbrojtur çështjen shqiptare në LK, KM ngriti komisionin të përbërë nga Mehdi Frashëri, Xhafer Villa, Mit'hat Frashëri.¹²¹

Shmangia e qeverisë greke nga zgjidhja e çështjeve të shqiptarëve, u la dorë të lirë autoriteteve shtetërore për zbatimin e politikës ndaj minoritetit çam. Të dhënat dokumentare të muajve prill-maj 1928, pasqyronin përkeqësimin e mëtejshëm të gjendjes në Çamëri dhe mobilizimin e tyre për të justifikuar dëbimin e saj para LK.¹²² U bënë presion banorëve të fshatrave të ndryshme për të nënshkruar tre deklarata, një për LK, një për qeverinë greke dhe atë turke, ku gjoja “shprehnin dëshirën” për t’u larguar në Turqi.¹²³ Në këtë linjë shkonte edhe veprimtaria e sillogjeve vorioepirote. Ekspozitë kryesorë të tyre, si kundërpeshë e ankimit të Shqipërisë në LK, shfrytëzuan shtypin për të kritikuar politikën e ndjekur prej saj ndaj minoritetit grek duke vënë theksin në shkeljen e të drejtave arsimore. Zbatimin e programit arsimor kombëtar shqiptar në këto shkolla, e shihnin si mjet për shqiptarizimin e ndërgjegjes greke të popullit kristian.¹²⁴ Ata i bënë thirrje qeverisë greke të mbronte të drejtat e tyre në LK, të ndreqte gabimet e qeverisë Pangallos, anëtarët kryesorë të së cilës i quajtën “shqiptarofilë të sëmurë” dhe kërkuan ripushtimin e Epirit Verior për të çliruar kristianët nga robërimi turko-shqiptar.¹²⁵ Qeveria shqiptare protestoi në LK ndaj politikës së qeverisë greke dhe veprimtarisë së sillogjeve në dëm të popullsisë çame dhe shtetit shqiptar.¹²⁶

Në prag të mbledhjes së Këshillit të LK, Parlamenti grek midis çështjeve të tjera shqyrtoi edhe atë të traktateve me Shqipërinë. Ministri i

¹²⁰ *Po aty*, V. 1928, D. 40, fl. 120, Telegram i MPJ të Shqipërisë drejtuar sekretarit të Përgjithshëm të LK në Gjenevë, Tiranë, 10 prill 1928; *po aty*, fl. 156.

¹²¹ *Po aty*, fl. 155, Vendim Nr. 193 i Këshillit të Ministrave, Tiranë, 14 prill 1928.

¹²² *AQSH*, F. 152, V. 1928, D. 94, fl. 7, Telegram i prefekturës së Gjirokastrës drejtuar MPB, Gjirokastrë, 10 maj 1928; *po aty*, fl. 9, Telegram i komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë drejtuar MPB, Tiranë, 23 maj 1928; *po aty*, fl. 15, Telegram i Prefekturës së Gjirokastrës drejtuar MPB, Gjirokastrë, 26 maj 1928.

¹²³ *AMPJ*, V. 1928, D. 40, fl. 187, Telegram i Zyrës së Shtypit në MPJ drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Tiranë, maj 1928.

¹²⁴ *Po aty*, fl. 263-265, Gazeta “Nea Alithia”, Selanik, 18 maj 1928.

¹²⁵ *Po aty*, fl. 268, 19 maj 1928; *po aty*, 20 maj 1928

¹²⁶ *AMPJ*, V. 1928, D. 40, fl. 189, Telegram i Mit'hat Frashërit, drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të LK, Tiranë, 18 maj 1928; *AQSH*, F. 149, V. 1928, D. 1-880, fl.2, Telegram i MPJ drejtuar KM, Tiranë, 23 prill 1928.

Jashtëm u kërkoi deputetëve të mos insistonin për votimin e konventës konsullore e të vendbanimit me Shqipërinë, sepse në referim të saj, shpërblimi për shqiptarët ishte gati i barabartë me vlerën totale të pasurisë së tyre. Sipas Ministrisë së Bujqësisë, kjo shumë shkonte në 1 milion strema me vlerë 900 milion dhrahmi dhe deklaroi se bashkë me ministrin e Bujqësisë, do të mbronin çështjen në LK.¹²⁷

Nga ana e saj qeveria shqiptare dhe komisioni u angazhuan në përgatitjen e materialeve për t'u mbrojtur në LK në mënyrë sa më të argumentuar dhe udhëzoi përfaqësitë diplomatike në kryeqytetet e mëdha për të siguruar mbështetje për këtë çështje.¹²⁸ Edhe shtypi shqiptar brenda e jashtë vendit, pasqyroi situatën në marrëdhëniet shqiptaro-greke, mbështeti përpjekjet e qeverisë shqiptare për të zgjidhur çështjet në bisedime dypalëshe, trajtoi gjerësisht gjendjen e shqiptarëve në Greqi, veçanërisht mohimin e të drejtave dhe lirive të shqiptarëve në Çamëri, politikën e ndjekur nga shteti grek në vazhdimësi për t'i dëbuar ata nga vatrat e tyre.¹²⁹

Në mbështetje të çështjes së shqiptarëve në Greqi, dolën edhe drejtuesit e Shoqërisë të Lindjes së Afërme dhe të Mesme, të cilët, në letrën e botuar në gazetën "The Times", i bënë thirrje LK, t'i kërkonte qeverisë greke të përmbushte premtimet e bëra para kësaj organizate, për zgjidhjen e problemeve të shqiptarëve në Greqi dhe veçanërisht për njohjen e të drejtave civile, politike e arsimore të minoritetit shqiptar të Çamërisë. "Ne besojmë, theksonin ata, se një zgjidhje e shpejtë dhe e drejtë e këtyre çështjeve kërkon drejtësi ndërkombëtare dhe i takon drejtpërdrejt nderit dhe prestigjit të LK."¹³⁰ Ndaj tyre reagoi përfaqësuesi i legatës greke në Londër, Caclamanos, i cili, mbështeti politikën greke ndaj shqiptarëve dhe në veçanti ndaj minoritetit çam.¹³¹

¹²⁷ AMPJ, V. 1928, D. 40, fl.182-183, Gazeta "La Messenger d' Athenes", 17 maj 1928.

¹²⁸ Po aty, fl. 202-207, Telegram i legatës shqiptare në Londër drejtuar MPJ, Londër, 19 qershor 1928.

¹²⁹ "Minoritetet në Greqi", në gazetën *Dielli*, nr. 4064 (757), Boston, 17 prill 1928, f. 4; "Çështja çame", në gazetën *Dielli*, nr. 4068 (761), 1 maj 1928, f. 2.

¹³⁰ AMPJ, V. 1928, D. 40, fl. 306, Gazeta "The Times", Londër, 7 qershor 1928. Letër e Presidentit Henry C. Bentinck për zëvendëspresidentin Lamington.

¹³¹ Po aty, fl. 315-316, Letër e D. Caclamanos, drejtuar redaksisë së gazetës "The Times", Londër, 8 qershor 1928; po aty, fl. 335, Gazeta "The Times", Londër, 21 qershor 1928. Letër e Ekrem Vlorës, drejtuar redaksisë "The Times", 14 qershor 1928. Përfaqësuesi i Shqipërisë në Londër, E. Vlora i drejtoi një letër gazetës "The Times", me anën e të cilës kundërshtonte përmbytjen e letrës së Caclamanos, që anashkalonte

Më 4 qershor 1928 nisi punimet mbledhja e Këshillit të LK ku e mori fjalën I. Vrioni. Ai denoncoi politikën e shtetit grek ndaj shqiptarëve dhe i kërkoi Këshillit të LK, që të këshillonte Greqinë për t'u njohur pakicave shqiptare të drejtat e tyre. Përfaqësuesi i Greqisë, Politis, duke iu referuar çështjes nga ana teknike, synoi të rrëzonte kërkesën e Shqipërisë qysh në fillim, me pretendimin se asnjë shtet, i cili nuk ishte anëtar i Këshillit të LK, nuk kishte të drejtë për të paraqitur çështjen e minoriteteve para Këshillit. Por, pretendimi i tij u kundërshtua nga sekretari i Punëve të Jashtme të Britanisë së Madhe, A. Chamberlaine dhe delegati gjerman Schubert.¹³²

Më 5 qershor, Mehdi Frashëri në raportin e tij trajtoi çështjen e pasurisë së shqiptarëve dhe gjendjen e minoritetit çam në Greqi. Ai evidentoi përpjekjet e qeverisë shqiptare, për të gjetur një zgjidhje miqësore me qeverinë greke duke dhënë prova të një shpirti sakrifice qoftë dhe në dëm të nënshtetasve të saj. Refuzimi i propozimeve të Tiranës nga qeveria greke, nuk i la rrugë tjetër asaj për të gjetur një zgjidhje për mijëra familje shqiptare që kishin mbetur pa asnjë mjet jetese për shkak të konfiskimit të pasurive.¹³³ Raporti analizoi në mënyrë të sintetizuar masat dhe veprimet e shtetit grek, fill pas aneksimit të territoreve shqiptare dhe veçanërisht pas Luftës së Parë Botërore, të cilat ishin në kundërshtim me traktatet ndërkombëtare të nënshkruara edhe prej tij. Ato kishin çuar në konfiskimin e pasurive rurale, rekuizimin e shpronësimit të myslimanëve shqiptarë të përfshirë në shkëmbimin e popullsisë dhe mohimin e kombësisë së tyre, në spastrimin etnik të Çamërisë, si dhe në mohimin e të drejtave ekonomike, politike, kulturore të saj, duke krijuar një gjendje psikologjike të disfavorshme tek ata.¹³⁴

Qeveria shqiptare për t'i dhënë fund kësaj gjendjeje dhe për të arritur një zgjidhje pak a shumë të drejtë, i propozonte Këshillit të formonte një komision mikst i përbërë nga dy delegatë shqiptarë dhe dy grekë të emëruar, nën kryesinë e një delegati të një shteti neutral, të emëruar në Këshillin e LK. Komisioni kishte si detyrë të zgjidhte

shkakun e vërtetë të gjendjes së vështirë të shqiptarëve në Greqi, për shkak të mosrespektimit të detyrave të shtetit kundrejt minoritetit.

¹³² Gazeta *Dielli*, nr. 4078 (771), Boston, 5 qershor 1928, f. 1.

¹³³ "Mbledhje e 50 e Këshillit të LK dhe çështja çame" në gazetën *Dielli*, nr. 4091 (784), Boston, 24 korrik 1928, f. 3-4; Shih edhe P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë ...*, f. 752.

¹³⁴ *Po aty*.

çështjen e pasurive të shqiptarëve në Greqi, duke marrë si shembull marrëveshjet e lidhura midis qeverisë greke dhe qeverive të tjera. Ajo pranonte të zbriste çmimin e pasurive deri në 20% mbi çmimet e caktuara për shtetasit e këtyre shteteve.¹³⁵ M. Frashëri kërkoi që qeveria greke të zbatonte në praktikë premtimet e saj për të ndaluar masat për largimin e pjesës së mbetur të popullsisë çame jashtë trojeve të saj, t'u kthente pasuritë e sekuestruara padrejtësisht dhe të largonte refugjatët grekë nga shtëpitë e tyre, njohjen e të drejtave politike, të drejtën për të patur shkolla për mësimin e gjuhës shqipe, etj. Nëse qeveria greke nuk ndryshonte sjelljen në mënyrë rrënjësore ndaj minoritetit shqiptar në Greqi, qeveria shqiptare shprehte shqetësimin për një vërshim të popullsisë çame në Shqipëri, gjë që do ta vinte atë në një gjendje të vështirë, e cila do të shoqërohej me ndërlikime ndërshtetërore.¹³⁶

Politis nuk e pranoi ankesën e qeverisë shqiptare, e quajti atë si një përpjekje të mbështetur në disa lëvizje pseudoirredentiste të nxitura nga disa grupe alogjene që sipas tij nuk përbënin minoritet të vërtetë dhe kishin si qëllim të turbullonin marrëdhëniet midis kombeve.¹³⁷

Në përfundim të diskutimeve, Këshilli formoi një komision me tre anëtarë i cili paraqiti raportin më 8 qershor para tij. Këshilli vendosi si mënyrën më të përshtatshme për zgjidhjen e çështjeve në diskutim, bisedimet e drejtpërdrejta midis dy shteteve duke i shoshitur ato me frymë pajtuese. Nëse pala greke nuk do të afrohej, atëherë Shqipërisë i mbetej rruga e hapur për t'iu drejtuar LK.¹³⁸ Këshilli, me këtë vendim i anashkaloi pothuajse tërësisht kërkesat thelbësore të raportit dhe ofroi si zgjidhje atë rrugë që qeveria shqiptare tashmë e kishte konsumuar tërësisht, por pa rezultat. Në këtë mënyrë ai i la Greqisë dorë të lirë, të vijonte edhe në të ardhmen politikën shkombëtarizuese ndaj minoritetit çam dhe të moszgjidhjes së çështjes së pronave të shqiptarëve në Greqi, e cila vijon të jetë e tillë deri në ditët e sotme. Gjithashtu, Këshilli nuk e mori parasysh pretendimin e palës shqiptare se lëvizja e popullsisë çame drejt Shqipërisë sipas nenit 11 të Paktit, mund të kërcënonte ruajtjen e

¹³⁵ *Po aty*; P. Milo, *Politika e Jashtme e Shqipërisë ...*, f. 759.

¹³⁶ *Po aty*.

¹³⁷ *AMPJ*, V. 1928, D. 40, fl. 203, Telegram i legatës shqiptare në Athinë drejtuar MPJ, Athinë, qershor 1928; shih edhe gazetën *Dielli*, 4085 (778), Boston, 29 qershor 1928, f. 4.

¹³⁸ Dh. Berati, *Shënime historike...*, f. 60.

pages në mes kombeve, me arsyetimin si të pambështetur në fakte.¹³⁹ Delegacioni shqiptar u kthye në Tiranë, më 16 qershor me shpresën se diskutimi i çështjes dhe prestigji moral i LK do të ndikonte mbi qeverinë greke për t'u afruar në bisedime për një zgjidhje miqësore të çështjes së pasurive dhe minoritetit shqiptar në Greqi.¹⁴⁰

S u m m a r y

ALBANIAN-GREEK RELATIONS DURING THE YEARS 1925-1928

The issue of good neighborly relations with Greece was on the focus of the Albanian state's foreign policy during the years 1925-1928. Within these relations the Albanian government tried to protect the rights of Cham minority and resolving of the issue of Albanians' realty in Greece and to afford the efforts in Athens to realize its political, territorial, cultural and education goals in the South of Albania. During these years, it did not stop striving to resolve the above issues through bilateral talks with Athens for the signing of the Treaties of citizenship, extradition, consular and residence, the provisions of which oblige the signatories to respect the rights of the Greek citizens of Albanian nationality and those of the Albanian citizens of Greek nationality in their respective countries. For solving of the problems of Albanians in Greece, Albanian government ratified them in the parliament while the Greek side, contrary to the obligations of the agreements and what she offered to the Albanian government, shedid not ratify them as well as not realized the exchange of their elements. Greek authorities, contrary to what they have stated in international institutions and given promises time after time, in practice they tried to realize the Cham ethnic cleansing and hinder resolution of Albanian properties in Greece. Since, a continuous opposition by the Greek government was put forward to the development of the bilateral talks and to resolve the issues that were laid for solution in front of the two-state, Albanian government addressed to the Section for the Protection of Minorities and the Council of the League of Nations. But, the international institutions with their indifference and inaction left hand free to Greek state, in violation of international and bilateral conventions to implement a series of measures that aggravated the situation of the Albanian minority in Greece, favored the removal of the Cham population from Chameria and left unresolved the issue of their assets.

¹³⁹ *AMPJ*, V. 1928, D. 40, fl. 338, Buletini i Përditshëm, Zyra e Shtypit, Tiranë, 17 qershor 1928.

¹⁴⁰ *Po aty*.